

1 E martë, 12 maj 2026

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit paraqiten përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 09.30

5 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Sekretare e seancës, ju  
6 lutem paraqitni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është  
8 lënda KSC-BC-2023-12, Prokuroria i Specializuar kundër Hashim  
9 Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe  
10 Hajredin Kuçit.

11 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Vërej që të gjithë të  
12 akuzuarit po na ndjekin përmes videolidhjes, nëse nuk po na  
13 dëgjojnë, ju lutem, të na njoftojnë.

14 Prokuroria, ka ndryshime në ekipin tuaj?

15 Z. HAFETZ: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Unë jam Josh Hafetz,  
16 Jemi të njëjtët, por znj. Pederson është zëvendësuar nga  
17 kolegu ynë Sebastian van Hooydonk. Faleminderit.

18 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mbrojtja? Dhe Mbrojtja  
19 shikoj që ka ndryshime, Mbrojtja e Thaçit.

20 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Mirëmëngjes. Ne jemi njësoj si  
21 dje, vetëm z. Greicevsci është larguar.

22 Z. GOODEN: [Përkthim] Mirëmëngjes. Z. Huw Bowden na ndjek  
23 përmes videolidhjes. Kështu që ky është i vetmi ndryshim nga  
24 ana jonë. Unë jam z. Derrick Gooden.

25 Z. EDWARDS: [Përkthim] Ne jemi njësoj si dhe dje. Z.

1 Holmes, do na ndjekë përmes videolidhjes pak më vonë.

2 Z. YOUNG: [Përkthim] Unë jam përfaqësues i z. Fazliu.

3 Kemi znj. Beqiri që na ndjek përmes videolidhjes.

4 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Ne jemi njësoj si dje.

5 Faleminderit.

6 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ju lutem, sillni

7 dëshmitaren.

8 Z. Hafetz, doni të shtoni ndonjë dokument në listën tuaj  
9 të materialeve.

10 Z. HAFETZ: [Përkthim] Po. Është një dokument që mund ta  
11 përdor me dëshmitaren dhe dua që ta shikoj transkriptin ë  
12 formën që e kemi aktualisht tani, që është shpërndarë të  
13 gjitha palëve, do të lutesha, që ky dokument të vendoset në  
14 listën e materialeve që ta shohim të gjithë së bashku.

15 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ka kundërshtime nga  
16 Mbrojtja?

17 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

18 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull, z. Hafetz,  
19 pranohet.

20 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

21 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirëmëngjes dhe mirë se u  
22 kthyet, Profesore Fraser. Uroj të keni pushuar gjatë natës.

23 DËSHMITARJA: [Përkthim] Po.

24 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Do të vazhdojmë me pyetjet  
25 nga ana e Prokurorisë, z. Hafetz.

1           Z. Hafetz, fjala është për ju.

2                       DËSHMITARJA: HELEN FRASER [Vijon]

3                       Pyetje të palës tjetër nga z. Hafetz: [Vazhdim]

4           Z. HAFETZ: [Përkthim]

5   PY.   Mirëmëngjesi.

6   PË.   Mirëmëngjesi.

7   PY.   Dua të flasim për një nga temat që diskutuam shkurtimisht  
8   edhe dje, nuk dua të thellohem shumë po thjesht për të  
9   qartësuar pak transkriptin.

10           Në faqen 45 dhe 46 të transkriptit të djeshëm është bërë  
11   një bisedë mes jush dhe znj. Menegon lidhur me shqetësimet që  
12   kishit ju për transkriptin e ZPS-së në këtë rast. Znj. Menegon  
13   ju pyeti:

14           "Në raportin tuaj, po ashtu keni përmendur si problematik  
15   interpretimin e tingujve të ndryshëm siç është kthimi i  
16   fletëve që shkon përtej asaj që mund të nxirret apo të  
17   zbardhet prej një audioje."

18           Dhe ju u përgjigjët kështu:

19           "Po. Kishte shumë shembuj syresh dhe janë përshkruar  
20   pikërisht në këtë formë. Shkon përtej asaj që mund të dëgjojë  
21   veshi i njeriut. Mbase duket sikur lëvizën fletët apo faqet e  
22   një libri, kështu që nuk është e qartë. Po ashtu më duket  
23   sikur lëviz dera. Po hyn apo po del personi? Këto për mendimin  
24   tim shkojnë përtej asaj që mund të zbardhet nga një audio."

25           Më pas, në faqen 95 e në vijim deri në faqen 100 të

1 transkriptit të djeshëm, pasi diskutuam së bashku rishikimin  
2 që i kishit bërë ju audioincizimeve dhe transkriptimeve dhe  
3 fazat e ndryshme që keni pasur ju në çështje të ndryshme  
4 gjyqësore mes të cilave Eastman, ju thatë që në këto raste  
5 janë perceptuar tinguj të ndryshëm të audios, për shembull,  
6 komentet e një ndeshjeje futbolli në sfond apo një emision  
7 radio edhe shumë tinguj të ndryshëm që ndërhyjnë në bisedë,  
8 episode pëshpërimash që mund të interpretoheshin.

9 A ju kujtohet ky diskutim i djeshëm?

10 PË. Po.

11 PY. Po ashtu në një rast ju kishit bërë një konstatim ku një  
12 person pëshpëriste, në mënyrë të fshehtë mesa dukej dhe një  
13 person tjetër afër mikrofonit u përgjigj. Ju kujtohet kjo?

14 PË. Po.

15 PY. Përfundimisht u pajtuat me mua se është e mundshme që  
16 transkriptuesi apo transkriptuesit e ZPS-së në këtë rast, pra,  
17 ishte e mundshme që këta persona ta kenë dëgjuar siç duhet, ta  
18 kenë zbardhur siç duhet në transkript tingullin e zhurmës së  
19 letrave. A u pajtuat me këtë?

20 PË. Po, pajtohem. Po.

21 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Hafetz, duhet t'ju  
22 rikujtoj që është shumë e rëndësishme të bëni një pauzë mes  
23 pyetjeve dhe përgjigjeve. Prisni të përfundojë dëshmitarja  
24 përgjigjen pastaj bëni pyetjen.

25 Njësoj dhe për ju, znj. Fraser.

1           Z. HAFETZ: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

2   PY.   Pra, nuk ka ndonjë keqkomunikim kur them "zhurmë  
3   letrash", "fëshfërimë letrash" është njësoj si të themi,  
4   domethënë, e thënë në fjalë të tjera është thjesht është  
5   zhurmë tingulli i një letre?

6   PË.   Po.

7   PY.   Ju thoni po ashtu gjatë diskutimit, që nuk ju pëlqen  
8   termi "objektivisht e zbardhshme", të paktën për zhurmat e  
9   letrës apo tinguj të tjerë. A ju kujtohet kjo?

10   PË.   Po.

11           Z. HAFETZ: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të vendosë në  
12   ekran materialin 1D136 dhe shkoni në faqen 19. Shkojmë në fund  
13   të faqes 19.

14   PY.   Profesore, a keni një kopje të raportit me vete?

15   PË.   Po.

16   PY.   Shohim në fund të faqes, ju thoni në raportin tuaj se:

17           "Transkriptet po ashtu përfshijnë shumë komente  
18   kontekstuale lidhur me personat që hyjnë dhe dalin nga dhoma,  
19   interpretim të tingujve të ndryshëm si fëshfërimat e letrave  
20   apo kthimi i fageve - të gjitha këto shkojnë përtej asaj që  
21   është objektivisht e transkriptueshme nga vetë audio."

22           Pikë së pari, a mund të pajtohem të paktën sa i takon  
23   fëshfërimës së letrave apo zhurmës së letrave, kjo pjesë e  
24   raportit nuk vlen, është e pasaktë, a mund ta themi këtë?

25   PË.   E pasaktë. E kuptoj çfarë doni të thoni. Ju po thoni që

1 meqenëse unë kam thënë që shkon përtej asaj që është e  
2 transkriptueshme.

3 PY. Nuk po e sugjeroj, unë po e them. Ju dje thatë se  
4 përkthyesit e ZPS-së mund ta kenë dëgjuar një tingull që është  
5 i transkriptueshëm objektivisht dhe në këtë rast është zhurma  
6 e lëvizjes së letrave, zhurma letrash. A e diskutuam këtë dje?  
7 PË. Po.

8 PY. Dhe besoj se u pajtuam sepse është e transkriptueshme në  
9 fakt, është e mundshme, ka qenë e mundshme për përkthyesit e  
10 transkriptuesit e ZPS-së që në mënyrë objektive të kenë  
11 transkriptuar dhe dëgjuar zhurmën, fëshfërimën e letrave gjatë  
12 një incizimi, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Atëherë, kjo pjesë e raportit i takon që është e pasaktë?

15 PË. Nuk e kuptoj këtë. Mbase unë po ju keqkuptoj, nuk mund të  
16 them që nuk jam dakord me këtë që kam shkruar në paragrafin e  
17 fundit.

18 PY. Ta marrim atëherë ta zbërthejmë, ta marrim fjalë për  
19 fjalë.

20 Ju thoni që në transkript ka shumë komente kontekstuale,  
21 mes të cilave edhe komente lidhur me zhurmën e letrave, zhurmë  
22 letrash?

23 PË. Unë e kuptoj ku është keqkuptimi. Unë këtu kam dashur t'i  
24 referohem që kam thënë që mund të ketë pasur zhurmë që është  
25 kthimi i faqeve apo zhurmë letrash, por ka qenë e paqartë. Nga

1 ta dinë këta persona që ktheheshin faqet, ktheheshin fletët,  
2 si e kanë dalluar këtë gjë?

3 PY. Pra, ju thoni që nuk mund të transkriptohet tingulli si  
4 tingulli i kthimit të fletëve?

5 PË. Është çështja tek terminologjia që disa tinguj janë  
6 objektivisht të transkriptueshëm dhe të tjerë jo. Mendoj që  
7 është e vështirë të kuptohet se çfarë vërtet mund të  
8 transkriptohet në mënyrë objektive nga një audio. Koncepti në  
9 vetvete është i vështirë.

10 PY. Po ju jeni personi që keni thënë këtu fjalën  
11 "objektivisht i transkriptueshëm". Tani vetë ju s'po kuptoni  
12 terminologjinë tuaj?

13 PË. Kam thënë shkon përtej asaj që është objektivisht e  
14 transkriptueshme. Nuk kam thënë që është "objektivisht e  
15 transkriptueshme".

16 PY. Ju e keni problem vetë termin që keni përdorur  
17 "objektivisht e transkriptueshme" në raportin tuaj?

18 PË. Jo. Nuk jam kundër kësaj që kam thënë, nuk po e hedh  
19 poshtë këtë që kam thënë.

20 PY. Atëherë, tani këtu, sot, a besoni ju që një transkriptues  
21 i ZPS-së që ka zbardhur tingullin e zhurmës së letrës në  
22 transkript, pra, sipas jush, "kjo shkon përtej asaj që është  
23 objektivisht e transkriptueshme nga një audio"?

24 PË. Mendoj se interpretimi -- unë po përpiqem këtë t'ju them,  
25 interpretimi i tingujve. Unë nuk jam kundër kësaj që kam

1 thënë. Por unë besoj se disa nga komentet që janë bërë, për  
2 shembull, personat që hyjnë e dalin nga dhoma, interpretimi që  
3 u është bërë disa tingujve shkon përtej asaj që është  
4 objektivisht e transkriptueshme nga një audio.

5 PY. Por jo për zhurmën e letrës, apo jo?

6 PË. Nëse dëgjon një zhurmë fëshfërimash, fëshfërimë, si mund  
7 ta dish me siguri që është fëshfërimë letre apo është  
8 fëshfërimë e një sendi apo një objekti tjetër. Këto janë  
9 interpretime. Të gjitha këto janë interpretime.

10 PY. Pyetja është kjo: Ky tingull në vetvete a është  
11 objektivisht i transkriptueshëm, apo jo?

12 PË. Nuk e di nëse po e kuptojmë në të njëjtën mënyrë këtë  
13 raport. Besoj se këtu kam folur, në raportin tim dhe pjesën që  
14 keni marrë ju parasysh, kam folur për zhurmën që ishte në  
15 sfond në televizor. Tani nuk mund ta di tani çfarë kam dashur  
16 të them sepse mund të ketë pasur aspekte të tjera që janë  
17 marrë parasysh në atë rast. Unë mendoj që një transkriptues ka  
18 bërë të pamundurën për të kuptuar se çfarë ka ndodhur, siç ka  
19 qenë dhe rasti i transkriptuesve tuaj.

20 PY. Dr. Fraser, a mendoni ju, a është e mundur, keni më shumë  
21 se 30 vjet përvojë në këtë fushë, a mendoni që një  
22 transkriptues i ZPS-së e ka shënuar siç duhet në transkript  
23 tingullin e zhurmës së letrës siç e kanë dëgjuar, mendoni se  
24 kanë qenë objektivë?

25 PË. Nuk ju kuptova.



1 PY. Siç e kanë dëgjuar në incizim mendoni se e kanë zbardhur  
2 siç duhet?

3 PË. Po.

4 PY. Faleminderit. Flasim tani për komunikimin tuaj me  
5 Mbrojtjen dhe materialet që keni marrë.

6 PË. Në rregull.

7 PY. Përpara se ta nënshkruanit raportin, në 27 mars 2026, a i  
8 dhatë Mbrojtjes ndonjë version paraprak të papërfunduar të  
9 raportit?

10 PË. Po.

11 PY. Po ju këtu keni ardhur në cilësinë e ekspertes, duhet të  
12 përgjigjeni me po apo jo.

13 PË. Po, ia dhashë.

14 PY. Sa versione u keni dhënë?

15 PË. Nuk e kujtoj.

16 PY. Më shumë se një?

17 PË. Me gjasë, po.

18 PY. Më shumë se dy?

19 PË. Nuk mund t'i përgjigjem me siguri lidhur me këtë.

20 PY. Përafërsisht kur i keni dorëzuar këto versione që nga  
21 fillimi i detyrës në dhjetor dhe deri në përfundimin e detyrës  
22 tuaj më 27 mars, në ç'periudhë kohore i keni dhënë këto  
23 versione të papërfunduara drafte?

24 PË. Nuk më kujtohen datat e sakta?

25 PË. Me përafërsi.

1 PË. Vërtet as me përfaqësi nuk mund t'ua them.

2 PY. Morët ndonjë koment nga Mbrojtja lidhur me raportet -- më  
3 lejoni të përfundoj ju lutem. Pra, morët ndonjë koment?

4 PË. Po.

5 PY. Si i morët me email, me *Teams* apo me platforma të tjera  
6 të komunikimit *online* apo përmes telefonit?

7 PË. Jam e sigurtë që nuk ka qenë me telefon. Kemi komunikuar  
8 me email, kemi biseduar dhe në *Zoom*.

9 PY. Si ishin këto biseda, çfarë shije të lanë këto biseda?

10 PË. Thjesht kemi diskutuar materialet.

11 PY. A ju bënë pyetje vijuese lidhur me informacionet që  
12 kishit hedhur në raport?

13 PË. Po.

14 PY. I dhatë përgjigje me shkrim apo gojë?

15 PË. Po.

16 PY. Me shkrim?

17 PË. Shumicën e përgjigjeve i kam dhënë gjatë bisedave me  
18 gojë.

19 PY. A morët shënime lidhur me bisedat?

20 PË. Po.

21 PY. A e përshtatët raportin bazuar në udhëzimet dhe pyetjet e  
22 Mbrojtjes?

23 PË. Ka të ngjarë, po nuk më kujtohet saktësisht se çfarë kam  
24 bërë.

25 PY. A ju kujtohet ndonjë prej pyetjeve apo udhëzimeve vijuese

1    që ju dha Mbrojtja gjatë këtyre bisedave? Ju kujtohet cila  
2    ishte lënda për çfarë ju pyetën? Çfarë ju kërkuan të  
3    ndryshonit, të shtjellonit në raportin tuaj?

4    PË.   Kryesisht më bënë pyetje sqaruese.

5    PY.   Në raportin tuaj nuk keni shënuar asgjëkundi që keni  
6    pasur dhe versione të mëparshme?

7    PË.   Jo.

8    PY.   As nuk shënoni se cilat pyetje ju bëri më tej Mbrojtja?

9    PË.   Jo, nuk e kam shënuar këtë.

10   PY.   Tani juve nuk ju kujtohet, ne duhet të hamendësojmë?

11   PË.   Nuk e mendova që ishte kriter që duhet t'i shkruaja këto.

12   PY.   Po ne nuk e dimë tani çfarë udhëzimesh keni marrë prej  
13   Mbrojtjes, çfarë pyetjesh ju bëri Mbrojtja, ne nuk e dimë?

14   PË.   Jo, nuk e di. Mbase mund të pyesni ata. Unë nuk e di.

15   PY.   Ne prej jush nuk mund ta marrim këtë informacion?

16   PË.   Jo, prej meje jo.

17   PY.   Lidhur me korrespondencën që keni pasur me shkrim,  
18   përafërsisht sa emaile keni shkëmbyer me Mbrojtjen nga fundi i  
19   dhjetorit deri më 27 mars?

20   PË.   Nuk e di.

21   PY.   Më shumë apo më pak se dhjetë?

22   PË.   Më shumë se dhjetë besoj.

23   PY.   Më shumë se 20 apo më pak se 20?

24   PË.   Nuk mund t'i përgjigjem kësaj.

25   PY.   A mund të them se disa nga këto emaile kanë pasur

1 udhëzime të mëtejshme?

2 PË. Shumica e pyetjeve nga sa më kujtohet ishin pyetje  
3 sqaruese.

4 PY. A mund të më jepni një shembull?

5 PË. Jo, më vjen keq, nuk mundem.

6 PY. Sipas raportit tuaj në pjesën 3 keni marrë gjashtë audio  
7 të papërforsuara prej Mbrojtjes?

8 PË. Po.

9 PY. Secila prej dosjeve kishte audio nga pesë minuta?

10 PË. Po.

11 PY. Më pas keni marrë dy dosje të tjera me audio të  
12 përforsuara?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe këto nga pesë minuta.

15 PË. Kam përshtypjen që njëra prej tyre ishte më e shkurtër,  
16 po do të më duhet ta verifikoj.

17 PY. Po ky ishte, pak a shumë, numri i dosjeve audio që keni  
18 marrë nga Mbrojtja, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Po të ishin më shumë?

21 PË. Atëherë do t'i kisha përmendur në raport.

22 PY. Atëherë ne mund të hamendësojmë me të drejtë që ju keni  
23 marrë tetë dosje audio, apo jo?

24 PË. Mund të kem marrë dhe të tjera që s'i kam përmendur në  
25 raport. Jam përpjekur t'i hedh në raport të gjitha materialet

1     që kam marrë, por nuk më kujtohet me saktësi. Mund të ketë

2     pasur dhe të tjera të cilat nuk i kam përmendur në raport.

3     PY.   Kur thoni "kam marrë" nga Mbrojtja?

4     PË.   Po, nga Mbrojtja.

5     PY.   Pra, ju po thoni që është e mundur që t'ju kenë dërguar

6     më shumë dosje audio që s'i keni shënuar në raport?

7     PË.   Kam shkarkuar shumë materiale. Me singeritet nuk më

8     kujtohet numri i saktë. Sepse unë nuk i kam parë të gjitha

9     materialet e mëparshme. Mendova se do të bëheshin vetëm pyetje  
10    lidhur me ato që kam hedhur në raport.

11    PY.   Por ama ju pajtoheni me mua që kur bëni një raport ju

12    duhet të komentoni lidhur me të gjitha transkriptet dhe

13    materialet audio, po për këtë duhet të shënoni të gjitha

14    materialet që keni marrë nga Mbrojtja, apo jo?

15    PË.   Po.

16    PY.   Po mund të mos e keni bërë?

17    PË.   Mbase jo.

18    PY.   Nga 348 dosje audio që janë pranuar si provë në këtë

19    çështje gjyqësore, që mbulojnë më shumë se 28 orë audio

20    incizime, në raport thuhet se keni marrë në total thjesht tetë

21    audio, dosje me audio, që është më pak se 3 për qind?

22    PË.   S'kam bërë llogari, po në rregull.

23    PY.   Po kështu mund të jetë?

24    PË.   Po.

25    PY.   Pra, përveç nëse ka dhe dosje të tjera audio që i keni

1 marrë dhe i keni dëgjuar, por s'i keni shënuar në raportin  
2 tuaj, atëherë i bini që ju nuk dini asgjë lidhur me 97 për  
3 qindëshin e mbetur të dosjeve audio në këtë çështje gjyqësore,  
4 a mund ta themi këtë?

5 PË. Po.

6 PY. A e pyetët ndonjëherë Mbrojtjen e Thaçit në komunikimet e  
7 shumta që keni pasur nga dhjetori deri në mars 2025, 2026  
8 përkatësisht, pra, a e pyetët ndonjëherë Mbrojtjen t'ju jepte  
9 më shumë audio sesa tetë audiot që ka dhënë dhe që keni  
10 përfshirë në raportin tuaj?

11 PË. Jo, nuk e pyeta.

12 PY. Në fund të faqes 3, në fillim të faqes 4 të raportit  
13 tuaj, që është 1D136, ju thoni se keni marrë segmente të  
14 audios --

15 PË. Një çast që ta gjej në raport, ju lutem. Ju po thoni  
16 fundi i faqes 3, fillimi i faqes 4?

17 PY. Po.

18 PË. Në rregull. Po.

19 PY. Pra, ju thoni që keni marrë segmente të audioincizimeve  
20 vetëm nga 3 shtatori deri në 6 tetor 2023, apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe këtu i referohem në raportin tuaj në faqen 3 pjesës  
23 3.1, geramat (a) deri në (f). E shihni këtë?

24 PË. Po.

25 PY. Që ta sqarojmë, që të jetë i qartë transkripti. Dje

1 mendoj se ka qenë një gabim, në fakt, duhet ta korrigjojmë  
2 këtë. Në faqen 46 të transkriptit, dje pra, znj. Menegon ju  
3 pyeti - në transkript nga rreshtat 20 deri në 23 - lidhur me  
4 besueshmërinë e audiove të vizitave të z. Kuçi, që bëhet fjalë  
5 për vizitën e 3 shtatorit 2023 dhe vizitën e z. Smakaj, ju  
6 keni thënë se nuk flisni shqip, po keni përdorur mjete të  
7 tjera, instrumente të tjera për të verifikuar cilësinë. Dhe iu  
8 tha, a mund të themi që këto pjesë të audios janë të  
9 padëgjueshme.

10 Vizita e Smakajt mund të jetë ose e 9 shtatorit 2023 apo  
11 7 tetorit 2023. Ma merr mendja që këtu ka qenë një gabim sepse  
12 ju s'kemi marrë asnjë audio sipas këtij raporti nga vizitat e  
13 z. Smakaj të shtatorit apo të tetorit, apo jo?

14 Pra, kur ju bënë këtë pyetje lidhur me aspektet e  
15 padeshifrueshëm të audioincizimit lidhur me vizitat e Smakajt,  
16 atëherë nuk mund t'i përgjigjeni se nuk keni asnjë formacion  
17 për këto vizita?

18 PË. Po. Duket se kështu është. Por është e drejtë që kam  
19 pasur vizitë të 3 shtatorit dhe të 6 tetorit. Më vjen keq s'i  
20 kam kushtuar rëndësi emrave të vizitorëve. Dhe jam përpjekur  
21 të jem e qartë, kam pasur qasje vetëm në këto dosje të këtyre  
22 datave. Nëse mund të kem bërë gabim për emrat e personave,  
23 atëherë ju kërkoj ndjesë.

24 PY. Nuk është nevoja të kërkonit ndjesë, ne thjesht duhet të  
25 korrigjojmë transkriptin dhe të sigurohemi që të paktën mesa

1 keni ju dijeni ju nuk keni marrë dhe nuk keni komentuat lidhur  
2 me audioincizimet për z. Smakaj, kështu duket se është.

3 PË. I kam përmendur audiot që kam rishikuar që dhe sa më  
4 kujtohet është 3 shtatori dhe 6 tetori.

5 PY. Po. Kjo është që në fillim të raportit lidhur me dosjet  
6 audio?

7 PË. Po.

8 PY. Në qoftë se do shikoni faqen 4 të raportit tuaj, aty ju  
9 thoni se keni marrë versione të shumta të dy vizitave të  
10 ndryshme, atëherë pra, gjithmonë flitet për vizitën e 3  
11 shtatorit dhe 6 tetorit, apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe ju u përgjigjët pyetjeve të znj. Menegon dhe lidhur  
14 me versionet e rishikuara të këtyre dokumenteve, apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. Besoj që thatë dhe që do të ishte praktikë e mirë për  
17 Gjykatën që të përpiqet që të mbështetet në një version dhe jo  
18 në katër versione të ndryshme, a është e saktë kjo?

19 PË. Mesa më kujtohet tani nga biseda dhe me sa besoj unë,  
20 mendoj që është e vështirë për Gjykatën të vlerësojë versionet  
21 e ndryshme, kështu që unë thjesht po ngrija pikëpyetje lidhur  
22 me vlerën e versioneve të ndryshme.

23 PY. Mirë. Në rregull. A keni marrë pjesë të tjera të  
24 transkriptove të tjera përveç këtyre transkriptove që keni  
25 shënuar në këtë pjesë të raportit tuaj? Mbrojtja ju ka dhënë



1 ndonjë version tjetër?

2 PË. Mendoj se jo.

3 PY. Është jo absolute apo nuk jeni e sigurtë?

4 PË. Dua të them jo absolute, po mund të ketë ngjarë, mund të  
5 më jetë dhënë ndonjë informacion që nuk e kam pasqyruar këtu.

6 Nuk mund të them me siguri absolute. Megjithatë unë kam  
7 shkruar këtu gjithë informacionin, gjithë materialin që kam  
8 përdorur për hartimin e raportit.

9 PY. Le të supozojmë që ju nuk keni marrë transkripte të tjera  
10 ose nuk i keni lexuar ose nuk jeni mbështetur në to, i takon  
11 që ju nuk keni njohuri të transkriptove nga shtatë prej nëntë  
12 vizitave të regjistruara në këtë çështje gjyqësore?

13 PË. Unë nuk e di se sa regjistrime, incizime keni bërë juve,  
14 por unë kam vetëm këto dokumente të cilat po i diskutojmë.

15 Pra, e diskutuam dhe dje që ideja ishte që informacionet që  
16 mua më janë dhënë mendohet që ishin përfaqësuese.

17 PY. Këto konsideroheshin si përfaqësuese nga Mbrojtja apo jo?

18 PË. Po.

19 PY. Megjithatë, përveç këtyre transkripteve ju nuk keni parë  
20 asnjë transkript tjetër, apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. E njëjta gjë flet dhe për përkthimet, apo jo, Dëshmitare?

23 PË. Po.

24 PY. Nëse do shikojmë seksionin 3.4 në faqen 4 të raportit

25 tuaj, aty ju jepni katër dokumente, parashtime që ju ka dhënë

1 Mbrojtja lidhur me raportin tuaj. A e shikoni këtë pjesë,

2 Dëshmitare?

3 PË. Po.

4 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Por sapo më  
5 thanë sepse ju sapo i bëtë pyetjen dëshmitares lidhur me  
6 vizitën e Kuçit dhe të Smakajt për z. Thaçi dhe sapo më thanë  
7 që në transkriptin e përkohshëm referimi u bëhet këtyre dy  
8 personave, por sa i takon versionit origjinal, versioni  
9 origjinal vetëm i referohet vizitës së Kuçit dhe të Kilajt,  
10 kjo sa për procesverbal.

11 Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit. Faleminderit që e  
12 ngritët këtë. Keni të drejtë.

13 Do i lutesh Sekretarisë tani të paraqesë në ekran  
14 dokumentin SPOE00411742, që përfundon me 411747.

15 PY. Profesore Fraser, më datën 15 prill, sikurse mund ta  
16 shikoni nga emaili që keni përpara në ekran, pra, më 15 prill  
17 të këtij viti, ZPS-ja domethënë, zyra ime, ka marrë nga  
18 Mbrojtja e Thaçit një përgjigje ndaj një kërkesë tonës për  
19 informacione sa i takon atyre informacioneve që ishin dhënë  
20 juve prej Mbrojtjes.

21 Z. HAFETZ: [Përkthim] Të shohim pak faqen 3 të  
22 dokumentit, që përfundon me 745. Të kalojmë pak më poshtë në  
23 faqe nëse s'është problem. Faleminderit. Edhe pak më lart, pak  
24 më sipër në faqe.

25 PY. Atëherë më 15 prill 2026 dhe më 15 mars 2026, thuhet në

1 këtë email që juve ju është dhënë informacion tjetër plotësues  
2 prej Mbrojtjes. A e shikoni këtë?

3 PË. Po.

4 PY. Domethënë, siç raportohet këtu bëhet fjalë për politika  
5 të DHSK-së dhe politikat të lidhura me gjuhët e punës. A e  
6 shikoni, Dëshmitare?

7 PË. Po.

8 PY. A i keni rishikuar, a i keni analizuar këto dokumente,  
9 Dëshmitare?

10 PË. Po, e di që kam lexuar dokumentin për Gjuhët e Punës së  
11 Gjykatës. Dhe nuk e di cili ishte dokumenti tjetër. Po, tani e  
12 pashë dhe besoj se dhe këtë dokument tjetër e kam rishikuar  
13 për arsye të raportit.

14 PY. Por në raportin tuaj ju nuk është se keni thënë që e keni  
15 lexuar ose e keni analizuar këtë Vendim për Gjuhët e Punës së  
16 Gjykatës, apo jo?

17 PË. Po, e drejtë, nuk e kam pasqyruar.

18 PY. Po lidhur me materialet e tjera që keni marrë më 15  
19 shkurt dhe më 15 mars të 2026, sipas komunikimit me Mbrojtjen?

20 PË. Nuk e kuptova, mund ta thoni edhe një herë?

21 PY. Po. A i keni parë këto dokumente që ju janë dhënë më datë  
22 15 shkurt dhe 15 mars?

23 PË. Për çfarë dokumentesh e keni fjalën?

24 PY. Janë dokumentet që ju janë dhënë ju sipas këtij emaili më  
25 15 shkurt.

1 PË. Po, është dokumenti që ka të bëjë me gjuhët e punës, me  
2 përkthimin dhe interpretimin. Po pa diskutim që më kujtohet që  
3 kam lexuar vendimet e lidhura me gjuhët e punës në Gjykatë.

4 Mbase nuk e kam parë me hollësi dokumentet e tjera, por nuk  
5 jam e sigurtë. Nuk di t'i përgjigjem kësaj pyetjeje.

6 PY. Por po t'i kishit lexuar besoj se do i kishit shënuar në  
7 raport, apo jo?

8 PË. Jo domosdoshmërisht. Mendoj që mbase mund të kemi pasur  
9 ndonjë bisedë, ndonjë diskutim në goftë se duhej që të  
10 pasqyroja që e kam rishikuar Vendimin për Gjuhët e Punës.

11 Mendoj që këshilla që mu dha ishte që nuk ishte e nevojshme që  
12 të pasqyrohej kjo në raport. Pra, këtë koment ia bëra znj.

13 Menegon. Nuk e kam studiuar në hollësi Vendimin për Gjuhët e  
14 Punës, kështu që nuk e gjykova me vend që ta pasqyroja dhe të  
15 thoja që e kam rishikuar, e kam parë me hollësi.

16 PY. Kur thoni që e kam njoftuar ose kam informuar znj.

17 Menegon, për çfarë e keni fjalën?

18 PË. E kam fjalën që e diskutuam në një prej drafteve në  
19 versionet paraprake.

20 PY. Domethënë, po thoni që në një prej versioneve paraprake  
21 ju e keni cituar që keni shqyrtuar Vendimin për Gjuhët e  
22 Punës?

23 PË. Jo, jo. Nuk po them këtë gjë. Megjithatë, me ju thënë të  
24 drejtën, me qenë e sigurtë, nuk është se e kam parë si të  
25 rëndësishme pasqyrimin e kësaj ose nuk kam pritur që të më

1 bëhen këto pyetje.

2 PY. Për të qenë i qartë, për çfarë diskutuat ju lidhur me  
3 raportin paraprak dhe çfarë pune keni bërë juve ose çfarë  
4 pyetje keni ngritur me znj. Menegon?

5 PË. Mendoj që kam bërë pyetjen që a është e nevojshme që të  
6 vendos në raport Vendimin për Gjuhët e Punës.

7 PY. Po ju e keni rishikuar këtë vendim, apo jo?

8 PË. E kam rishikuar sipërfaqësisht por jo në hollësi.

9 PY. Por e keni parë, pra, e keni shqyrtuar po nuk e keni  
10 përfshirë?

11 PË. Me qenë e singertë nuk di t'ju them. Nuk më kujtohet në  
12 qoftë se e kam përfshirë në një version paraprak apo jo.

13 PY. Po sa i takon politikave të DHSK-së lidhur me përkthimin  
14 dhe interpretimin, a e keni lexuar këtë dokument?

15 PË. Nuk jam e sigurtë. Gjithsesi nuk e kam studiuar me  
16 hollësi.

17 PY. Po lidhur me Shërbimet e Verifikimit, Udhëzimet për  
18 Rishikimet e Përkthimit dhe Interpretimeve dhe Udhëzimet e  
19 DHSK-së, a e keni lexuar këtë dokument?

20 PË. Nuk e mbaj mend. Nuk mund t'ju them, më duhet ta shikoj  
21 dokumentin për t'u siguruar.

22 PY. Në faqen 21 të raportit tuaj në një pjesë ku flitet për  
23 procesin e vlerësimit, ju thoni që procesi i verifikimit është  
24 "tërësisht i papërshtatshëm". A ju kujtohet kjo?

25 PË. Po. Po i referohesha rishikimit të LSU-së, të Njësisë së

1 Shërbimeve Gjuhësore dhe rishikimit me transkriptin si dhe me  
2 versionin në audio.

3 PY. Ndërkohë që ju bëni këtë cilësim për punën e bërë, ju  
4 mund ose mund të mos keni rishikuar disa politika të lidhura  
5 me përkthimin, me interpretimin, me verifikimet e kështu me  
6 radhë, domethënë, do ishte e nevojshme që të lexonit këto  
7 dokumente përpara sesa të mbërrinit në një konkluzion të  
8 tillë, apo jo?

9 PË. Pa diskutim që kam parë vendimin për gjuhët e punës,  
10 ndërkohë që nuk besoj që e kam parë me kaq shumë hollësi dhe  
11 nuk e kam kuptuar krejtësisht procesin e verifikimit.

12 PY. Por siç thoni në raportin tuaj, ju keni katër parashtime  
13 të protokolluara, dy prej të cilëve janë vendime të Gjykatës  
14 dhe dy prej të cilëve janë dosje, parashtime ligjore të  
15 lidhura me Prokurorinë, apo jo?

16 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Dua të korrigjoj diçka.  
17 Domethënë, thjesht cilësimi është "tërësisht i  
18 papërshtatshëm".

19 Z. HAFETZ: [Përkthim] Po. Absolutisht. Keni të drejtë.

20 PY. Domethënë, ju thatë "tërësisht të papërshtatshme".

21 Z. HAFETZ: [Përkthim] Falënderoj për korrigjimin që më  
22 bëtë kolege.

23 PY. Profesore Fraser, a ju kujtohet një bisedë me avokatin e  
24 Mbrojtjes që mbase mund të ketë qenë përmes postës elektronike  
25 ose telefonit ose përmes mjeteve të tjera të komunikimit, a ju

1 kujtohet një bisedë ku ju është bërë pyetja, domethënë, është  
2 një bisedë përpara seancës përgatitore, pra, ku i është bërë  
3 pyetje për ndonjë mbështetje tjetër që mund të jepni për t'ju  
4 përgjigjur pyetjeve që rrjedhin nga vendimi i Gjykatësit  
5 lidhur me procesin e verifikimit dhe raportin tuaj në  
6 përgjithësi? Ju kujtohet diçka e tillë?

7 PË. Nuk e di për çfarë e keni fjalën.

8 PY. A ju kujtohet që Mbrojtja t'ju ketë kërkuar që të  
9 komentoni konstatimet e Gjykatësit që, sipas mendimit të tij  
10 të pasqyruar në vendim, materiali juaj nuk dukej sikur kishte  
11 ndonjë bazë ligjore pas, nuk mbështetej në një bazë ligjore?  
12 A ju kujtohet kjo?

13 PË. Ju lutem a mund të ma thoni troç? A mund të ma thoni më  
14 qartë? Domethënë po thoni që në qoftë se m'u kërkua që të  
15 konstatoja ose të bëja komente lidhur me vendimin e  
16 Gjykatësit? Se nuk e kuptoj tamam?

17 PË. Në rregull. Le ta shohim më konkretisht për çfarë flasim.  
18 Le të shohim dokumentin me ERN 744, në fund të faqes.

19 PË. Ndërkohë që e kemi në ekran këtë më thoni -- dua që të  
20 sqaroj diçka që unë këtë dokument nuk e kam parë asnjëherë.

21 PY. Po kjo është e drejtë. Kjo është një përmbledhje e  
22 komunikimeve të Mbrojtjes lidhur me komunikimet që ata kanë  
23 pasur me ju, domethënë, është njoftimi që Mbrojtja na ka bërë  
24 ne. Është e drejtë që ju nuk e keni parë këtë dokument më  
25 përpara.

1 PË. Në rregull.

2 PY. Mirë. Në fund të faqes 3. Këtu thuhet që "Më 14 shkurt  
3 2025" që duhet të jetë 14 shkurt 2026, apo jo, Dëshmitare?

4 PË. Po, po. Besoj se po. Dhe gjithashtu kam mbajtur shënimin  
5 që duhet të jetë 2 shkurt 2026.

6 PY. Këto të dyja janë lapsuse, janë gabime që kanë kaluar,  
7 apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. Po ju në shkurt të 2025-s nuk është se keni qenë e  
10 angazhuar me çështjen, apo jo?

11 PË. Po, e drejtë.

12 PY. Atëherë në këtë email të dërguar nga Mbrojtja e Thaçit  
13 thuhet që:

14 "Në 14 shkurt 2025, Profesore Fraser ka marrë vendimin  
15 F00737 që ka pranuar transkriptet e ZPS-së" dhe asaj i thënë  
16 si më poshtë.

17 PË. A mund ta lexoj vetë?

18 PY. Po, patjetër mund ta lexoni.

19 PË. Po, e pashë. Po.

20 PY. Sa për sqarim, e kuptoj që këtë dokument nuk e keni parë  
21 më përpara.

22 Z. HAFETZ: [Përkthim] Por ndoshta sa për sqarim do ishte  
23 mirë që dëshmitarja të shikojë dhe faqen pasardhëse, ta  
24 shikojë të plotë komunikimin.

25 DËSHMITARJA: [Përkthim] Po.



1 Z. HAFETZ: [Përkthim]

2 PY. Së pari, a ju kujtohet që keni biseduar një herë ose më  
3 shumë herë me Mbrojtjen e Thaçit lidhur me pikat kryesore të  
4 përmbledhura në fund të faqes 3 dhe në fillim të faqes 4?

5 PË. Po. Jo në hollësi, po tani që pashë dokumentin më  
6 kujtohet që kemi diskutuar.

7 PY. Kur thuhet tek kjo pika për shkurtin e 2026-s, që juve ju  
8 tha informacioni që jepet këtu, në çfarë forme ua thanë këtë  
9 informacion?

10 PË. Ju lutem, a mund ta shohim dhe një herë këtë pjesë të  
11 faqes? Kalojmë tek faqja më përpara. Mendoj që më ka ardhur  
12 përmes një emaili.

13 PY. Po përgjigjen e bëtë përmes postës elektronike?

14 PË. Jo, besoj se jo. Besoj që kemi pasur një bisedë përmes  
15 Zoom nëse më kujtohet drejt.

16 PY. A ju kujtohet pak a shumë se sa pas shkurtit 2026 ka  
17 ndodhur kjo bisedë ose ky komunikim përmes Zoom?

18 PË. Nuk më kujtohet.

19 PY. A ju kujtohet se si i jeni përgjigjur pyetjes konkrete që  
20 ju ka bërë Mbrojtja, e kam fjalën për pyetjet që përmenden në  
21 paragrafin 35 dhe 36 të vendimit 737?

22 PË. Nuk më kujtohet ekzaktësisht se çfarë kam thënë asokohe.  
23 Po mundohem që të kujtoj në mendjen time se çfarë thuhet në  
24 këta paragrafë, domethënë, në paragrafin 35 dhe 36. Mbase më  
25 kujtohet në drekë, po mbase jo. Nuk jam shumë e sigurtë.

1           Z. HAFETZ: [Përkthim] Do i lutem Sekretares të paraqesë  
2   në ekran vendimin F00737 dhe konkretisht kërkoj që të  
3   paraqiten në ekran paragrafi 35 dhe 36. Faleminderit, znj.  
4   Sekretare.

5   PY.   Profesore Fraser, ju lutem lexojeni me mendje dhe pasi të  
6   keni përfunduar me paragrafin 35, na thoni që të ndërrojmë  
7   faqen për të vijuar me paragrafin 36.

8   PË.   Ju lutem vazhdoni me paragrafin tjetër. Vazhdojmë me  
9   paragrafin tjetër, me faqen tjetër. Faleminderit. Mendoj se  
10   përfundova së lexuari. Domethënë, vetëm dy paragrafët 35 dhe  
11   36, apo jo?

12   PË.   Po, e saktë. A ju kujtohet që t'i keni lexuar këta dy  
13   paragrafë kur keni përgatitur raportin?

14   PË.   Po.

15   PY.   Keni pasur disa biseda me Mbrojtjen e Thaçit lidhur me  
16   këta dy paragrafë, apo jo?

17   PË.   Po.

18   PY.   A ju kujtohen këto biseda konkretisht?

19   PË.   Në hollësi nuk më kujtohen, po në vija të përgjithshme,  
20   po, më kujtohen.

21   PY.   A është diçka kjo që është trajtuar në versione të  
22   ndryshme paraprake të raportit tuaj, në një version paraprak  
23   ose disa versione paraprake?

24   PË.   Jo, nuk mendoj se ka qenë ky rasti.

25   PY.   Profesore Fraser, dua t'ju bëj disa pyetje lidhur me

1 përfundimet tuaja lidhur me raportin, në mënyrë të tillë që të  
2 jemi të qartë. Nëse e keni përpara raportin, përfundimet i  
3 keni të shtjelluara në hollësi në faqen 22 dhe 23, apo jo?

4 PË. Po.

5 Z. HAFETZ: [Përkthim] Ju lutem paraqisni faqen 21, znj.  
6 Sekretare, si fillim, në qoftë se do shohim gjysmën e fundit  
7 të faqes 21, pra, drejt fundit të faqes 21 fillojnë  
8 përfundimet e raportit.

9 PY. Kjo është diçka që u ngrit dhe dje, megjithatë duket  
10 sikur ka dy përfundime të cilat pasqyrohen drejt fundit të  
11 faqes 21, a është e saktë kjo, Dëshmitare?

12 PË. Po.

13 PY. Thjesht po konfirmoj atë çfarë thatë.

14 PË. Po.

15 PY. Përfundimi i parë ka të bëjë me seksionin 7, a është  
16 kështu?

17 PË. Po, e saktë. Atëherë pjesa 7.8 është përfundim për pjesën  
18 7 të raportit. Ndërkohë që tek 8 fillojmë përfundimet për të  
19 gjithë raportin.

20 PY. Për shembull, te seksioni 7 që fillon në faqen 17 dhe nuk  
21 është e nevojshme që ta shikojmë, kjo pjesë ka të bëjë me  
22 lëndën gjyqësore aktuale, apo jo?

23 PË. Më lejoni një çast që ta konfirmoj se ka pasur raste kam  
24 bërë ndonjë gabim, ndonjë lapsus edhe më përpara.

25 PY. Po.

1 PË. Po, po, e drejtë.

2 PY. Dhe në seksionin 8 fillojnë përfundimet fundore, finale,  
3 le të themi të këtij raporti, apo jo? Domethënë, ju doni që  
4 Gjykata të përqendrohet te këto përfundime lidhur me raportin  
5 tuaj?

6 PË. Po, po.

7 PY. Dhe në këtë seksion thuhet që:

8 "Unë nuk kam mundësi që të vlerësoj ose jam e pamundur që  
9 të vlerësoj mbështetshmerinë e këtyre përkthimeve mbështetur  
10 në informacionin që më është dhënë."

11 Kur thua "të këtyre përkthimeve" për kë përkthime e keni  
12 fjalën, Dëshmitare?

13 PË. Kam përshtypjen që bëhet fjalë për përkthimet e dy  
14 vizitave që kemi diskutuar, domethënë, të vizitave të 3  
15 shtatorit dhe të 6 tetorit.

16 PY. Përkthime për të cilat ju keni marrë gjithsej 8 incizime  
17 në audio prej të cilave dy versione të përforcuara të të  
18 njëjtave versione në audio, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Pra, këto përfundimet të tuat nuk aplikohen ose nuk  
21 zbatohen mbi përkthimet e tjera që kanë të bëjnë me këtë lëndë  
22 gjyqësore, apo jo?

23 PË. Jo, unë jam përqendruar vetëm thjesht tek ato përkthime  
24 që kam marrë.

25 PY. Po ju nuk e dini në qoftë se pjesët që keni marrë janë

1 përfaqësuese, apo jo?

2 PË. Unë nuk mund të them që nuk di asgjë lidhur me këto, por  
3 kam marrë komentet e Mbrojtjes lidhur me këtë. Besoj që doli  
4 qartë që unë nuk kam pas akses në më tepër sesa kaq dokumente.  
5 Gjithçka që kam shqyrtuar është pjesë e raportit tim dhe jam  
6 mbështetur në informacionin që më ka dhënë Mbrojtja dhe që  
7 është përfaqësuese e të gjithë kampionit të dokumenteve.

8 PY. A mund të them unë, që çdo referencë që ju keni bërë  
9 lidhur me përkthimet dhe transkriptet në seksionin 8 të  
10 raportit tuaj, që janë përfundimet e gjithsejta të raportit, i  
11 referohet vetëm përkthimeve dhe transkripteve të vizitës së 3  
12 shtatorit dhe vizitës së 6 tetorit, të dyja të vitit 2023?

13 PË. Besoj që kam qenë shumë e qartë lidhur me këtë. Unë këtë  
14 material kam pasur në dispozicion dhe më është thënë që këto  
15 materiale ishin përfaqësuese. Unë nuk kam parë materiale të  
16 tjera, kështu që përfundimet e mia i kam mbështetur në këto dy  
17 vizita, domethënë, materiale që më ka dhënë Mbrojtja lidhur me  
18 këto vizita.

19 PY. Profesore, ne as tani nuk jemi të sigurtë se çfarë  
20 materialesh ke marrë. Kështu që dua të jem i saktë kur thua  
21 çfarë materialesh ke marrë, domethënë, kur thua "ata", "ato  
22 materiale", "këto përkthime", "këto transkripte" e tjerë e  
23 tjerë.

24 Domethënë, dua që të jem ekzaktësisht 100 për qind i  
25 qartë, domethënë, të jesh e qartë për mua dhe për Gjykatën,

1 pra, në këto fjalë, me këto përemra, "ata", "ato", duam të  
2 dimë se për çfarë e ke fjalën konkretisht kur thua  
3 "mbështetëshmëria e tyre", ça, domethënë kush janë "ata", kush  
4 është "mbështetëshmëria e tyre" dhe dua ta bëj të qartë që çdo  
5 gjë që ti ke referuar tek përfundimet kanë të bëjnë me  
6 përkthimet dhe transkriptet e vizitave të 3 shtatorit dhe 6  
7 tetorit 2023. A është e saktë kjo?

8 PË. Po.

9 PY. Kur thua "Do kushtoja shumë vëmendje" dhe kur thua që  
10 "Përkthimet duken plotësisht ose tërësisht të jenë të paplota  
11 duke marrë parasysh krahasimin e tyre me provat e jashtme,  
12 pra, kur i krahason ato", atëherë gjithë krahasimi që ju bëni  
13 është përkthimi dhe transkriptimi i këtyre dy vizitave,  
14 vizitave të 3 shtatorit dhe të 6 tetorit, apo jo?

15 PË. Nuk më mbetet gjë tjetër veçse të përsërisë atë thashë  
16 dhe pak më herët, domethënë, unë përfundimet e mia i kam  
17 mbështetur në ato dokumente që i kam konstatuar dhe që janë  
18 bërë të qarta në raport. Unë mendoj që ato kanë qenë  
19 përfaqësuese të të gjithë dokumentacionit dhe prandaj kam bërë  
20 këtë analizë dhe kam arritur në këtë përfundim. Sigurisht që  
21 analizën time unë e kam mbështetur në këto vizita që ju i  
22 përmendët disa herë deri tani.

23 PY. Pyetja që po ju bëj është pak ndryshe, Profesore.

24 PË. Në rregull.

25 PY. Unë po ju pyes këtë: Kur ju shkruani raportin dhe kur i

1 thoni Gjykatës që duhet të jenë të kujdesshëm për  
2 interpretimin dhe trajtimin e këtyre raporteve dhe kur përdor  
3 këto përemrat "ato, "ata", "këto raporte", e të tjerë, besoj  
4 që pajtohem që ti duhet të jesh e qartë lidhur me atë çfarë  
5 po flet, apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Atëherë i takon që thirrja për kujdes që bëni juve është  
8 e kufizuar, është e kufizuar vetëm për transkriptet e datës 3  
9 shtator dhe 6 tetor, apo jo?.

10 PË. Nuk dua që ta përsërisë veten dhe një herë se e thashë  
11 disa herë, por, po. Dhe për aq sa kohë sa që këto dokumente  
12 për këto dy vizita janë përfaqësuese. Po unë nuk jam personi  
13 që duhet ta vlerësoj në qoftë se jam përfaqësuese apo jo. Por  
14 deri në masën që këto dy vizita, dokumentet e lidhura me to  
15 janë përfaqësuese, atëherë i takon që ky të jetë një kampion i  
16 mirë për përfaqësimin e plotë të dokumentacionit dhe për  
17 përfundimet përkatëse.

18 Z. HAFETZ: [Përkthim] Besoj se është koha e përshtatshme  
19 për të përfunduar.

20 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po zakonisht e bëjmë në  
21 orën 11.00 pushimin e kafes.

22 Z. HAFETZ: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

23 PY. Dëshiroj që të bëj disa pyetje lidhur me kategorinë e  
24 versionin në audio dhe incizimet.

25 PË. Po.

1 PY. Në raportin tuaj identifikohet si audio e qartë, e  
2 dëgjueshme për çdo folës kompetent të gjuhës që të jetë në  
3 gjendje ta kuptojë?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe audio e paqartë është audioja që kërkon një dëgjim të  
6 kujdesshëm, të vëmendshëm, por që mund të kuptohet nga  
7 transkriptues profesionistë mbi bazën e kontekstit të  
8 brendshëm vetëm?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe pastaj kemi kategorinë e tretë që është audio e  
11 padallueshme, e padëgjueshme, qartë, pra, për të cilën mund të  
12 bëhen dallime të ndryshme nga dëgjues të aftë për të bërë  
13 këtë, duke patur ndikim nga pritshmëri të jashtme të ndryshme  
14 që kanë ndikim tek rezultati i asaj që dëgjohet?

15 PË. Po.

16 PY. Këto përkufizime të përshkruara në raportin tuaj janë  
17 pastaj të zgjeruara dhe të përshkruara në seancën përgatitore  
18 që keni patur me Mbrojtjen?

19 PË. Po.

20 PY. Ne trajtuam pak dje këtë temë po që të jemi të qartë.  
21 Këto tre kategori janë kyçe, thelbësore në përfundimin tuaj që  
22 sapo diskutuam në raportin tuaj?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe konkretisht, vlerësimi juaj sa i përket se cila  
25 kategori zbatohet në segmentet e audios të keni dëgjuar në



1 këtë çështje është çështje thelbësore mbi të cilën ju jeni  
2 mbështetur në përfundimin tuaj lidhur me mbështetëshmërinë e  
3 transkripteve të Prokurorisë dhe përkthimeve të tyre?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe kjo është përshkruar në faqen 21, 22?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe konkretisht në fund të faqes 21 dhe në krye të faqes  
8 22, ju arrini në përfundimin se, kjo është në krye 22:

9 "Duke qenë se provat e jashtme kanë ndikuar transkriptin,  
10 ka një rrezik të qartë të arsyetimit që ngelet në vetvete i  
11 natyrës së tillë që mund të krijojë padrejtësi sa i takon  
12 provave forensike të ndryshme, pra, përfshirë këtu provat që  
13 kanë të bëjnë me fjalimin apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. Kur thoni "megënëse", "sepse" do të thotë "për shkak se"?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe pastaj mbështetet në kategorizimin e audios, sipas  
18 mendimit tuaj, e padallueshme, e paqartë?

19 PË. E paqartë, e padallueshme, mendoj të dyja.

20 PY. Por e paqartë, në qoftë se është e paqartë nuk ka nevojë  
21 që detyrimisht që të duhet informacion i jashtëm, në qoftë se  
22 është në këtë kategori?

23 PË. Jo detyrimisht.

24 PY. Dhe fjala "megënëse" kjo është nga përdorimi juaj i  
25 programit *ChatGPT Whisper*?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe, në fakt, pa këtë vlerësim, vlerësimi i duhur i  
3 qartësisë, kuptueshmërisë, pra, të kësaj kategorie,  
4 përfundimet tuaj nuk qëndrojnë fare, apo jo?

5 PË. Pra, pa këtë vlerësim? Pa vlerësimin e dëgjueshmërisë dhe  
6 kuptueshmërisë?

7 PY. Përfundimet tua nuk qëndrojnë pastaj fare?

8 PË. Në qoftë se ka qenë incizim, regjistrim i qartë do të  
9 ishte situatë e ndryshme tërësisht.

10 PY. Tani në qoftë se është vlerësuar nga ju, pra, që e keni  
11 vlerësuar ju, por vlerësimi juaj i këtij incizimi është pjesë  
12 kyçe tejet e rëndësishme?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe ky është vlerësimi mbi të cilin jeni mbështetur për  
15 njërën prej programeve të Inteligjencës Artificiale?

16 PË. Nuk mendoj që jam mbështetur tërësisht në të. Mendoj që e  
17 kam mbështetur në vlerësimin tim të bërë të materialeve, po  
18 ashtu dhe transkriptimi i Inteligjencës Artificiale ka qenë  
19 pjesë e saj por nuk ka qenë e tëra kjo.

20 PY. Pjesa tjetër, që e keni shënuar në paragrafin 27 të  
21 seancës përgatitore, u keni dhënë përshtypjet tuaja si një  
22 person që nuk flet gjuhën shqipe?

23 PË. Si ekspert që nuk flet gjuhën shqipe në transkriptimin e  
24 audios forensike, pra, audio forensike dhe transkript  
25 forensik.

1 PY. Pra, këto janë përshtypjet tuaja?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe së bashku me përshtypjet tuaja si person që nuk  
4 flisni gjuhën shqipe dhe *ChatGPT*?

5 PË. Në rregull.

6 PY. Nuk është në rregull. Është po ose jo.

7 PË. Shumë pyetje nuk janë në të vërtetë për përgjigje po ose  
8 jo në atë mënyrë, por po e pranoj atë që po thoni ju.

9 PY. Nuk bëhet fjalë që ta pranoni atë që po them, Profesore.  
10 Bëhet fjalë që t'i përgjigjeni pyetjes dhe mund t'ju lexoj  
11 përsëri atë nëse ju dëshironi.

12 Së bashku janë përshtypjet tuaja si person që nuk flet  
13 gjuhën shqipe dhe përdorim i *ChatGPT*?

10 që dëshmitari të vendosë të ndryshojë dhe përgjigjet e  
11 pyetjeve të tjera.

12 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Besoj që është e drejtë dhe  
13 e arsyeshme tani që teksti të jetë përpara dëshmitares në  
14 mënyrë që ajo të komentojë.

15 Profesore Fraser, gjithmonë keni të drejtë që të sqaroni,  
16 të shpjegoni ose të thoni që nuk keni dakord me një term të  
17 caktuar që përdoret nga Prokurori, por në qoftë se nuk na e  
18 thoni shprehimisht që nuk pajtoheni me një term të caktuar që  
19 përdoret dhe në qoftë se thoni "po", i takon që ju pajtoheni  
20 me termat për të cilat ju bën pyetje Prokurori. Kjo është  
21 mënyra e punës këtu përpara Gjykatës.

22 Z. Hafetz, atëhere vazhdojmë me pyetjet tuaja. Paraqisni  
23 transkriptin dëshmitares dhe të shohim se si do vazhdojmë më  
24 tej.

25 Z. HAFETZ: [Përkthim]

1 PY. Duke filluar nga rreshti 9 i transkriptit:

2 "Vlerësimi, domethënë, vlerësimi për kontekstin e jashtëm  
3 është i domosdoshëm dhe është thelbësor për përfundimet që ju  
4 keni. Është e saktë kjo, apo jo?"

5 Ju përgjigjeni:

6 "Po, kjo është e saktë."

7 A e vini në pikëpyetje këtë gjë tani apo jo? E ndryshoni  
8 përgjigjen?

9 PË. Sigurisht që jo. Konteksti i jashtëm është i domosdoshëm  
10 për përfundimet e raportit tim. Por, ju duket sikur po  
11 pretendoni që testi me inteligjencë artificiale ka qenë  
12 thelbësor për vlerësimin tim për kontekst të jashtëm, gjë të  
13 cilën unë e kam sqaruar më herët sot paradite. Dhe në qoftë se  
14 do të ishte bërë kjo kërkesë edhe përpara se ta përdorja  
15 inteligjencën artificiale, pra, përpara disa viteve kur nuk  
16 ekzistonin platformat e inteligjencës artificiale, njësoj, në  
17 të njëjtin përfundim do kisha mbërritur sikurse ja u shpjegova  
18 sot paradite. Dhe nga ekspertiza ime, nga incizimet e audio  
19 forensike, transkriptimi forensik, dhe po e theksoj dhe një  
20 herë që inteligjencën artificiale e kam përdorur si për  
21 ilustrim. I qëndroj kësaj që kam përdorur. Ka qenë  
22 ilustrative, ishte e dobishme, më ka ndihmuar mua, shpresoj që  
23 do ta ndihmojë dhe Gjykatën. Megjithatë ajo çfarë dua të  
24 theksoj dhe një herë është që ky incizim në audio nuk mund të  
25 transkriptohet pa informacion ose pa kontekst të jashtëm.

1 Z. HAFETZ: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, i nderuar  
2 Gjykatës, dëshiroj që të vazhdoj me faqen tjetër.

3 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po, por na jepni pak  
4 kontekstin përpara se mund të vazhdoni më tej.

5 Në rregull. E pamë edhe pak më poshtë faqen e  
6 transkriptit kështu që mund të vazhdoni.

7 Z. HAFETZ: [Përkthim] Në rregull.

8 PY. Tek faqja tjetër thuhet, këtu thuhet:

9 "Për shkak se ju nuk e flisni shqipen, dhe përderisa nuk  
10 keni pasur qasje në persona që e njohin mirë shqipe --"

11 Dhe ju thoni: "Po, po, ëhë".

12 Unë vazhdoj më tej:

13 "Ju keni vlerësuar cilësinë e audios duke përdorur një  
14 instrument transkriptimi të inteligjencës artificiale.

15 Domethënë, fjalia e parë e seksionit e vlerësimit tuaj që  
16 është baza e raportit tuaj fillon me përdorimin e ChatGPT 5,  
17 apo jo? E saktë kjo?"

18 Domethënë, kjo është pjesa e transkriptit të djeshëm.

19 Dëshironi që të vazhdoni deri në fund të faqes dhe pastaj e  
20 lexoj unë me pjesën tjetër?

21 PË. E lexova deri në fund të faqes.

22 Z. HAFETZ: [Përkthim] Në rregull. Vazhdojmë me faqen  
23 tjetër. Kalojmë më poshtë.

24 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] E shikoj që nuk i keni  
25 kufjet, por përkthyesit bëjnë një shënim, ju lutem bëni një

Dëshmitarja: Helen Fraser (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Hafetz (Vazhdim)

Faqe 78

1     pauzë midis pyetjeve dhe përgjigjeve. Kjo vlen si për

2     Prokurorin ashtu edhe për Profesoren Fraser.

3             Z. HAFETZ: [Përkthim]

4     PY.   Pra në qoftë se do kalojmë tek faqja 18, ju thoni:

5             "Po."

6             Pyetja ime është kjo:

7             "Vlerësimi ose përdorimi i ChatGPT 5 për këtë vlerësim a  
8     është diçka që keni përdorur?"

9             "Po."

10            "Kjo ka qenë, përdorimi i ChatGPT 5, ka qenë thelbësor i  
11     domosdoshëm për raportin tuaj?"

12            Ju përgjigjeni:

13            "Po".

14     PË.   Është pyetje kjo? Se pajtohem me këtë që është shkruar,  
15     po e ndjek

16     PY.   Në rregull.

17            Z. HAFETZ: [Përkthim] Vazhdojmë me faqen tjetër. Dëshiroj  
18     që të kalojmë seancë private.

19            GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Le të kalojmë në seancë  
20     private.

21            Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo, më mirë është të vazhdojmë  
22     seancë publike dhe pastaj do kërkoj që të kalojmë në seancë  
23     private.

24            GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po. Por, të njëjtën gjë  
25     doja të theksoja edhe një herë, z. Hafetz, që Gjykata është e

Dëshmitarja: Helen Fraser (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga Z. Hafetz (Vazhdim)

Faqe 79

1 aftë të kuptojë argumentet tuaja, mungesën e konsistencës,  
2 kështu që nuk jam i sigurt që shpjegime të mëtejshme nga  
3 dëshmitarja do na ndihmonin. Kështu që thjesht doja t'ju  
4 udhëzoja lidhur me këtë. Është e qartë ku doni të dilni.

5 Z. HAFETZ: [Përkthim]

6 PY. Sipas kodit të sjelljes që po e diskutonim pak më herët  
7 ju duhet të jeni e paanshme ose neutrale në vlerësimet tuaja,  
8 apo jo?

9 PË. Po.

10 Z. HAFETZ: [Përkthim] Atëherë të kalojmë te dokumenti  
11 2780, te dokumenti mëparshëm që po shihnim që ishte kodi i  
12 sjelljes. Me numër SPOE0124777. Të kalojmë më poshtë në faqe.

13 PY. Në këtë pjesë të kodit, në faqen 4, trajtohet mbledhja  
14 dhe trajtimi i të dhënave. A është kështu, dëshmitare?

15 PË. Po.

16 PY. A e keni pasur parasysh këtë pjesë të kodit kur keni  
17 punuar për raportin nga dhjetori 2025 deri në mars 2026?

18 PË. Nuk i jam referuar konkretisht gjatë kësaj periudhe,  
19 megjithatë e di përmbajtjen e kodit të sjelljes.

20 PY. A e dini në qoftë se ndonjë nga materialet në incizimet  
21 në audio përmbante emrat e dëshmitarëve?

22 PË. A e thoni dhe një herë pyetjen?

23 PY. Po. Domethënë a e dini në qoftë se në incizimet në audio  
24 përfshiheshin emrat e dëshmitarëve?

25 PË. Ma thoni dhe një herë.

1 PY. Po ta shpjegoj dhe një herë pyetjen. A jeni në dijeni në  
2 qoftë se ndonjë prej incizimeve në audio përfshinte emra të  
3 dëshmitarëve?

4 PË. Ajo çfarë di me siguri është që në incizimet në audio  
5 janë përfshirë emra personash, por, në qoftë se këto persona  
6 kanë qenë dëshmitarë apo jo këtë nuk e di.

7 PY. Dhe a janë këto incizimet që ju keni hedhur gjithsesi në  
8 platformat e inteligjencës artificiale, se ju keni hedhur  
9 pjesë të ndryshme, apo jo?

10 PË. Po, jam e sigurt që pjesët që i kam përdorur me  
11 inteligjencë artificiale kanë pasur emra.

12 Z. HAFETZ: [Përkthim] Le të vazhdojmë me faqen tjetër. Të  
13 kalojmë pak më poshtë.

14 PY. Në këtë pjesë ka dy paragrafë që kanë titullin "Përdorimi  
15 i Modeleve të Mëdha Gjuhësore". A e lexoni këtë, dëshmitare?

16 PË. Po, e lexoj.

17 PY. A e keni pasur parasysh këtë pjesë të kodit kur keni bërë  
18 raportin?

19 PË. Përsëri, nuk e kam lexuar konkretisht gjatë kësaj  
20 periudhe, po sigurisht që e di që përmban këtë pjesë kodit.

21 PY. A është e saktë që në këtë pjesë të kodit thuhet që  
22 përdoruesi ose anëtarët e shoqatës duhet të jenë të kujdesshëm  
23 për përdorimin e ChatGPT-së për sa i takon modeleve gjuhësore  
24 të mëdha?

25 PË. Po.



1 PY. Njëra prej arsyeve është që "modelet varen nga cilësia e  
2 të dhënave për të cilat janë trajnuar modelet, çfarë do të  
3 thotë që, përzgjedhja e të dhënave mund të ketë rezultat mbi--  
4 mund të ketë ndikim mbi rezultatet përdorimit të platformave"?

5 PË. Po.

6 PY. Në kod thuhet më tej se:

7 "Në shumë LLM të caktuara, domethënë, trajnimi i të  
8 dhënave është i është i panjohur."

9 PË. Po.

10 PY. Dhe sikurse diskutuam më përpara ju nuk dini asgjë lidhur  
11 me të dhënat për trajnimin e platformave të inteligjencës  
12 artificiale lidhur me shqipen, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Sa i takon përdorimit të LLM-së thuhet më tej që:

15 "Profesionistët duhet të jenë transparentë në qoftë se  
16 dhe kur përdorin LLM-të në punën e tyre, përfshirë dhe  
17 algoritmet e përdorura prej tyre dhe të dhënat e përdorura."

18 A e shikoni këtë ?

19 PË. Po.

20 PY. Në raport nuk thuhet specifikisht se cilin prej këtyre  
21 tre programeve ju keni përdorur për kë qëllim tuajin. Nuk do e  
22 them emrin e programeve tani.

23 PË. Po, sepse secila prej tyre përdor ChatGPT. Për këtë  
24 arsye, në veçanti Whisper.

25 PY. Ju e kuptoni që një kompani si ajo që keni përdorur ju

1 *online* ka marrëdhëniet e veta me ChatGPT, pra, ka marrëdhënie

2 konkrete ose specifike me ChatGPT?

3 PË. Po.

4 PY. Dhe ju e kuptoni që kompania mund të ketë punuar me

5 modele të ndryshme dhe të ketë modifikuar ndoshta të dhënat që

6 ka marrë nga ChatGPT?

7 PË. Ka modifikuar të dhënat e ChatGPT?

8 PY. Po.

9 PË. Nuk e di, po sigurisht, domethënë, që ka modele të

10 ndryshme që mund të përzgjidhen.

11 PY. Dhe ju nuk e keni specifikuar se kë model keni përdorur,

12 apo jo?

13 PË. Po, e kam e kam specifikuar.

14 PY. Domethënë që keni përdorur ChatGPT dhe Whisper?

15 PË. Po.

16 PY. Në kod thuhet që "anëtarët duhet të kenë parasysh faktin

17 që të dhënat që i jepen këtyre modeleve i kalohen kompanive

18 për këto modele që potencialisht mund të shkelin

19 konfidencialitetin dhe të kenë ndikim mbi integritetin e

20 kërkitimit".

21 Besoj se këtë e dini, Dëshmitare, apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Dhe në kodin tjetër thuhet që:

24 "Modele të përgjithshme të gjuhës nuk mund të

25 zëvendësojnë ekspertizën njerëzore".

1 A e dini ju këtë gjë?

2 PË. Po.

3 PY. A e keni e keni marrë parasysh këtë pjesë të kodit kur  
4 keni vendosur që të mbështesni mbështeteni tek *Whisper* lidhur  
5 me vlerësimin tuaj për deshifrimin e incizimeve në audio, në  
6 vend që të përdornit folësit e shqipes, domethënë, personat që  
7 e kanë shqipen gjuhën nëne për të bërë vlerësimin?

8 PË. Nuk e kam bërë këtë lloj vlerësimi konkretisht,  
9 megjithatë jam në dijeni të këtij informacioni. Jam plotësisht  
10 dakord dhe mendoj që e kam ndjekur logjikën e përgjithshme.  
11 Nuk jam mbështetur kryesisht në ChatGPT, thjesht e kam  
12 përdorur si pjesë të vlerësimit të përgjithshëm, dhe besoj që  
13 kam qenë e qartë në këtë vlerësim. Unë e kam thënë që në  
14 fillim që nuk e flas shqipen dhe nuk kam pasur kontakt me  
15 folës të shqipes.

16 PY. Profesor Fraser, ju në raportin tuaj nuk keni përfshirë  
17 asnjë referencë lidhur me jurisprudencën ekzistuese, apo jo?

18 PË. Jo, nuk besoj se kam bërë një gjë të tillë.

19 PY. Më konkretisht nuk ka referenca në asnjë çështje që  
20 kërkon procedurat ose proceset ose metodologjinë që ju thoni  
21 duhet që të zbatohet në këtë lëndë gjyqësore, apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Sepse nuk ekziston asgjë e tillë, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Në fakt nuk ka dakordësi, as ndërmjet profesionistëve si

1 puna juaj, se cilat duhet të jenë këto procedura, apo jo?

2 PË. I diskutuam në hollësi dje, kështu që besoj që është e  
3 drejtë të thuhet që nuk ka dakordësi. E diskutuam gjerë e  
4 gjatë dje. Pra, e diskutuam se çfarë është e pranueshme dhe  
5 çfarë nuk është e pranueshme.

6 PY. Po pyetja ime nuk ishte në qoftë se ka dakordësi ndërmjet  
7 asaj çfarë nuk është e pranueshme. Unë pyeta në qoftë se ka  
8 dakordësi ndërmjet profesionistëve, dhe si puna juaj, lidhur  
9 me procedurat se metodologjinë që duhet të përdoret, apo jo?

10 PË. Dua ta shtjelloj pak përgjigjen time në qoftë se më  
11 lejoni, i nderuar Gjykatës. Mendoj se është e rëndësishme të  
12 bëhet dallimi lidhur me procedurat që duhet të ndiqen dhe  
13 procedurat që nuk duhet të ndiqen. Dhe procedurat që duhet të  
14 ndiqen, një prej tyre është që duhet të ketë, le të themi,  
15 distancë midis zbardhësve dhe prokurorisë në çështjen në  
16 fjalë, se përndryshe, domethënë, ideja është që mund të  
17 shikohet në të dyja anët e medaljes si diçka që nuk duhet të  
18 ndodhë ose si praktikë që duhet të mënjanohet.

19 PY. Më herët folëm për komunikimin e datës 14 shkurt 2026  
20 midis jush dhe Mbrojtjes, konkretisht për pyetjen që ju është  
21 bërë lidhur me Vendimin për Pranimin e Provave Jogojore,  
22 mocioni për prova jogojore, Vendimi është 737.

23 PË. Po.

24 PY. Kur juve u pyetët, dhe po citoj, dhe këtu po lexoj pjesën  
25 e tretë të fundit të SPOE00411744.

1 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mund ta shfaqim në ekran.

2 Z. HAFETZ: [Përkthim] ERN-ja është, pra është faqja 3 e  
3 SPOE00411742 deri në 747. Në qoftë se kalojmë tani në faqen 3  
4 të dokumentit në fund të faqes. Në rregull.

5 PY. Patët mundësi ta shikoni?

6 PË. A mund t'ju pyes? E shoh që është diçka që diskutuam më  
7 herët ku përmendet materiali që kam marrë dhe ka të bëjë me  
8 paragrafët në vendimin e arsyetuar. Në qoftë se është e  
9 mundur, a mund të tregoni për çfarë bëhet fjalë në këtë  
10 dokument? Duket sikur po i kërkohet diçka ZPS-së, por nuk jam  
11 e sigurt. A mund të më thoni?

12 PY. Po ju tregoj.

13 Z. HAFETZ: [Përkthim] Dhe për procesverbalin, i nderuar  
14 Gjykatës, duhet që këtij dokumenti t'i jepet një numër prove  
15 materiale provizore.

16 PY. Kjo është --

17 Z. HAFETZ: [Përkthim] Dhe pastaj ky dokument varet nga  
18 vendimi për pranimin e dëshmisë së dëshmitarit.

19 PY. Ky dokument përmban shkëmbime, pra, siç e shpjegova më  
20 herët midis Prokurorisë dhe Mbrojtjes së Thaçit me  
21 Prokurorinë, pra, ku Prokuroria kërkon informacione për diçka.  
22 Kërkon informacione nga Mbrojtja lidhur me udhëzimet që mund  
23 t'ju jenë dhënë juve.

24 PË. E shoh tani. E kuptoj, pyetje e saktë. Më ndihmon që ta  
25 kontekstualizoj dokumentin.

1 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Hafetz, kam përshtypjen  
2 se dëshmitarja është pak e ngatërruar se kush e autorizoi këtë  
3 -- kush e ka bërë këtë dokument, kush është autori.

4 Z. HAFETZ: [Përkthim] Do ta qartësoj.

5 PY. Profesore, nuk jeni autore ju e këtij dokumenti?

6 PË. Jo.

7 PY. Kjo është një seri emailësh, shkëmbimesh midis  
8 Prokurorisë dhe Mbrojtjes së Thaçit ku Prokurorisë i kërkohet  
9 informacion shtesë lidhur me krijimin e raportit tuaj,  
10 përfshirë edhe udhëzimet e mëtejshme që ju janë dhënë jashtë  
11 letrës që kemi pranuar, ku përmban -- e cila përmbante  
12 udhëzimet dhe cilat, në qoftë se ka, materiale ju janë dhënë  
13 juve që nuk janë të renditura në raportin tuaj. Dhe ne kemi  
14 vërtetuar se ka disa prej tyre. Më ndiqni?

15 PË. Po.

16 PY. Në rregull.

17 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Hafetz, që të jemi të  
18 qartë dhe ndoshta -- se duhet të qartësohet kjo çështje. Kjo  
19 është shkruar nga Mbrojtja e Thaçit, apo jo?

20 Z. HAFETZ: [Përkthim] Në fakt është korrespondenca midis  
21 palëve, por pjesa të cilën po përmendim tani të cilës i  
22 referohemi është, në fakt, e shkruar nga Mbrojtja e Thaçit ku  
23 shpjegohet -- ku shpjegon ndërveprimet që kanë patur me juve.  
24 Disa prej ndërveprimeve.

25 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull. Më fal që po

1 ndërhyj përsëri, por duhet që të jem i qartë për këtë. A është  
2 kjo pjesë e shkruar në italik e shkruar nga Mbrojtja e Thaçit?

3 Z. HAFETZ: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, i gjithë emaili  
4 është shkruar nga Mbrojtja e Thaçit. Nuk e di nëse kanë hequr  
5 apo kanë shtuar diçka tjetër.

6 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull.

7 Z. HAFETZ: [Përkthim]

8 PË. Pra, në fund të faqes 2, që të jemi të qartë, Mbrojtja,  
9 shkruar në italisht -- shkruan në, pra, është në italik, në  
10 formatin italik Prokurorisë dhe po citojmë:

11 "Dhe për të plotësuar informacionin që ju kemi dhënë për  
12 raportin tuaj, kemi mbledhur" -- ata po i shkruajnë asaj,  
13 kërkoj ndjesë. Nuk e di. Duket sikur asaj po i shkruajnë.

14 Dhe pastaj ata rendisin një seri pyetjesh, 1, është  
15 përgjigja ndaj emailit; 2, përgjigja ndaj parashtimit të  
16 Prokurorisë. Kush -- këto a ju janë dërguar juve kur janë  
17 shkruar?

18 PË. Më duken sikur i kam parë. Besoj që i kam marrë.

19 PY. Dhe kjo mbulon numrin 3, mund të kalojmë në faqen 3.

20 Në fund të faqes dua të trajtoj çështjen në vijim.

21 PË. Në rregull.

22 PY. Dhe po citoj "Mund të identifikoni aspekte apo pika në  
23 arsyetimin e Gjykatësit që justifikojnë që ju t'i trajtoni në  
24 raportin tuaj. Nga ana jonë mund të jeni në gjendje të  
25 përfshini diçka".

1 Pra, ju udhëzojnë drejt paragrafit 35 36 këtu?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe ju sot këto paragrafe i lexuat edhe sot?

4 PË. Po.

5 PY. Pastaj në fund të faqes duke iu referuar paragrafit 36

6 lexon, dhe po citoj:

7 "Paragrafi 36 thekson mungesën e vendimeve gjyqësore të  
8 cilat merren -- përmes të cilave miratohet analiza shkencore  
9 që ne e kemi në të cilën kemi kërkuar të mbështetemi. Dhe ju",  
10 e kam fjalën ju, Dr. Fraser, "a jeni në gjendje", pra, vijon  
11 më tej "të nënvizoni apo të jepni ndonjë shembull në raportin  
12 tuaj ku gjykatat kanë miratuar, pranuar qasjen të cilën ju e  
13 mbron. A mund të trajtoni faktin se pse disa gjykata kanë  
14 vendosur që të mos e pranojnë këtë qasje."

15 Tani folëm për disa prej korrespondencave, shkëmbimeve të  
16 mëtejshme që mund të kenë rezultuar nga kjo, ky shkëmbim dhe  
17 kjo ky hulumtim nuk gjendet në raportin tuaj. A është e saktë?

18 PË. Ky hulumtim?

19 PY. Ky hulumtim, pra, këto pyetjet që janë bërë nga Mbrojtja  
20 e Thaçit nuk ka përgjigje ndaj tyre?

21 PË. Nuk ka.

22 PY. Kërkohet që të ngadalësojmë për shkak të përkthimit.

23 PË. Kërkoj ndjesë. Është vështirë që të kuptohem.

24 PY. Ju a keni -- a i keni dhënë Mbrojtjes në mënyrë të ndarë  
25 ndonjë material të tillë duke iu përgjigjur kësaj pyetje?



1 PË. Tani gjatë seancës përgatitore të 5 majit Mbrojtja iu  
2 kthye temës së përgjithshme dhe ju pyeti se si ishte marrë --  
3 ishin marrë provat tuaja. Ju kujtohet kjo?

4 PË. Po.

5 PY. Ju kujtohet çfarë ju keni thënë atyre, Mbrojtjes?

6 PË. Mendoj që jemi kthyer tek ditët e para kur fillimet e  
7 linguistikës, pra, linguistika nuk shihej si shkencë. Mendoj,  
8 nuk më kujtohet që kemi -- nuk mendoj ta kemi diskutuar këtë  
9 dje, por kam folur me ata në një moment të caktuar që ndodh  
10 shpesh sepse nuk e di se sa prova, se si provat që jap unë apo  
11 dëshmitë që jap unë se si merret, si trajtohet, si vlerësohet  
12 nga gjykata. Nuk e di gjithmonë se çfarë pranohet dhe çfarë  
13 nuk pranohet. Dhe sigurisht mund të them që dëshmia ime është  
14 e pranuar në disa gjykata. Por mund të them gjithashtu, në  
15 përgjithësi, gjykatat, siç e kemi thënë pak më parë, gjykatat  
16 lejojnë zakonisht transkriptet dhe përkthimet, veçanërisht  
17 transkriptet që janë fusha kryesore e ekspertizës time.  
18 Gjykatat në përgjithësi pranojnë transkriptet e audiove të  
19 padallueshme që janë krijuar përmes mënyrave që shkenca që  
20 merret me audiot e padallueshme nuk do t'i konsideronte,  
21 vlerësonte si transkripte të mbështetshme.

22 PY. Dhe duke kuptuar, pra, duke pranuar që ju nuk keni qenë  
23 gjithmonë e vetëdijshme apo keni patur informacion për  
24 rezultatin apo mënyrën, peshën që i është dhënë dëshmisë që  
25 keni dhënë ju apo rezultateve që keni paraqitur në një çështje

1 të veçantë, a keni ndonjë dijeni për ndonjë gjë?

2 PË. Di je një për çfarë?

3 PY. A keni dijeni, a jeni në dijeni të ndonjë shembulli? Pra,  
4 për t'iu përgjigjur pyetjes që Mbrojtja ju bëri juve, ku  
5 provat, dëshmia juaj është trajtuar -- mënyra se si është  
6 trajtuar, pra është pranuar, apo jo?

7 PË. Kam dijeni për disa, por nuk kam, nuk më kujtohet një  
8 përmbledhje. Nuk mund t'ju jap një përgjigje të hollësishme  
9 kësaj pyetje.

10 PY. Kur ata, Mbrojtja, ju pyeti juve me 5 maj gjatë seancës  
11 përgatitore për dëshminë tuaj këtu lidhur me raportin të cilin  
12 ju i kërkon Gjykatës të pranojë, a keni thënë, dhe po citoj:  
13 "A mund të më jepni disa çaste, kam përgjigje dhe do të  
14 mendohem për këtë".

15 PË. Besoj se po flisja, e kisha fjalën që do të flisja më  
16 mirë më shumë për aspektet shkencore sesa aspektet ligjore.  
17 Dhe kjo është ajo që u përpoqa të bëj.

18 PY. Por, e kuptoni, Dr. Fraser, veçanërisht si një person që  
19 mbron, pra, mbështesni ndryshime në ndryshimin që duhet të  
20 bëhet në ekzaminimet e mëparshme të gjykatave të tjera në  
21 mënyrën se si e trajtojnë dhe peshojnë dëshminë që ju jepni,  
22 kjo mund të jetë e rëndësishme dhe relevante për këtë Gjykatë?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe është -- mund të jetë sigurisht e relevante, për  
25 shembull, dhe për aftësinë që ka prokuroria për të kuptuar dhe

1 për ta vlerësuar atë?

2 PË. Nuk jam i sigurt që pajtohem me këtë pikë të dytë.

3 PY. Por me pikën e parë pajtoheni?

4 PË. E kuptoj se gjykatat shpesh kanë -- marrin parasysh në  
5 një farë mënyre mënyrën se si gjykatat e tjera kanë trajtuar  
6 dëshmi të ngjashme në të kaluarën. Natyrisht që këtë e kuptoj.  
7 Po ashtu kuptoj që në këtë fushë të veçantë të transkriptimit  
8 forensik ka mospërputhje, disa mospërputhje midis mënyrës se  
9 si gjykatat trajtojnë këtë lloj dëshmie apo prova dhe mënyra  
10 se si -- e qasja shkencore është për të kuptuar transkriptimin  
11 e një audio të padallueshme, të pakuptueshme. Kjo është tema  
12 kryesore e punës time, siç e thatë edhe ju.

13 PY. Kërkoj ndjesë, por ju e kuptoni që ne jemi këtu për të  
14 diskutuar dëshminë tuaj, dhe në qoftë se mund të përfundoj,  
15 pyetja që ju është bërë nga Mbrojtja e Thapit ishte se si  
16 dëshmia e juaj është trajtuar?

17 PË. Të përgjigjem?

18 PY. Përgjigju.

19 PË. Po, kështu është. Që të them disa gjëra. Së pari, nuk jam  
20 gjithmonë në dijeni se si dëshmia ime trajtohet në gjykatë.  
21 Jam në dijeni, mendoj, ju kam dhënë disa shembuj më herët sot  
22 dhe ndoshta dhe dje pasdite, se vendime në raste -- për raste,  
23 pra, ku vendime gjyqësore janë komentuar ndoshta në mënyrë  
24 negative lidhur me disa gjëra që kam thënë në raporte. Po  
25 përpiqem të zgjedh me kujdes fjalët, sepse natyrisht dua të

1 tregoj, të shfaq respekt ndaj gjykatave, por në disa raste  
2 mendoj se këto vendime gjyqësore nuk kanë qenë të sakta,  
3 faktualisht jo të sakta lidhur me dëshminë shkencore.

4 PY. Cilat konkretisht?

5 PË. Mendoj se ju përmendët dy prej tyre dje.

6 PY. Është Eastman, çështja Eastman?

7 PË. Mendoj, nuk më kujtohen fjalët e sakta, formulimi i saktë  
8 i aktvendimit. Mund ta keni ju. Është edhe çështja Clark.

9 PY. Përveç këtyre që përmenda në një kontekst tjetër dje,  
10 cilat janë rastet e tjera, në qoftë se ka ndër qindra raste në  
11 të cilat ju keni punuar më shumë se 100, për të cilat ju keni  
12 dijeni që prova -- dëshmia juaj se si është trajtuar dëshmia  
13 juaj?

14 PË. Kam shkruar raporte për rreth 100 çështje gjyqësore gjatë  
15 gjithë kësaj kohe. Pjesa dërrmuese e tyre nuk janë diskutuar  
16 në gjykatë.

17 PY. A e dini se sa prej tyre janë diskutuar në gjykatë?

18 PË. Siç e thashë jam paraqitur në gjykatë ndoshta rreth 12  
19 herë për të diskutuar raportet që kam dorëzuar.

20 PY. Ne kemi dy. E dini për ndonjë tjetër, pra, 10 të tjera që  
21 kanë ngelur?

22 PË. Kjo ndryshon. Me gjithë mend që nuk më kujtohet nuk kam  
23 mbajtur shënime të këtyre. Unë jam hulumtues edhe shkencëtare,  
24 jam e interesuar në temën, në mënyrën se si mund të sigurohemi  
25 që transkriptimi i audiove të padallueshme të bëhet, të jetë i

1 besueshëm dhe se si përdoret kjo në çështjen, gjykime penale  
2 si provë.

3 PY. Por, Doktor, ju jeni e vetëshpallur si në mbështetje,  
4 pra, të ndryshimit, kërkon ndryshim të kësaj teme në saktësi?  
5 PË. Po.

6 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ndoshta mund të shkojmë më  
7 tej, të lëvizim pak përpara duke paraqitur materialet që ju  
8 doni t'i paraqisni dëshmitares.

9 Z. HAFETZ: [Përkthim] Po përpigem të kuptoj lidhur me  
10 materialet e tjera përveç atyre që ishim në gjendje të  
11 identifikojmë, dhe të gjenim për kohën e shkurtër që kishim  
12 për të bërë këtë pyetje. Dhe mendoj që është e rëndësishme të  
13 kuptojmë nëse një individ që është mbështetës, pra, i  
14 vetëshpallur për ndryshim, duam të kuptojmë nëse është në  
15 dijeni, dhe në qoftë se nuk është, pse nuk janë në dijeni.  
16 Nëse ndonjë trajtim i mëtejshëm i vendimeve gjyqësore ka  
17 ndodhur, ose si janë si janë vlerësuar ato. Por kuptoj atë që  
18 po më thoni, z. Gjykatës.

19 PY. Profesore, si është trajtuar dëshmia juaj në çështjen  
20 Eastman, për aq sa mund t'ju kujtohet?

21 PË. Do preferoja që t'i përgjigjem kësaj pyetje me -- që të  
22 më jepet -- me kusht që të më jepet mundësia të rifreskoj  
23 kujtesën. Nuk jam e përgatitur fare dhe nuk po prisja që t'i  
24 përgjigjem pyetjeve për çështje të tjera, lidhur me çështje të  
25 tjera. Nëse më pyesni, do të përpigem të kujtoj atë që më

1 kujtohet, por nuk kam shumë besim se gjithçka që do të them  
2 është e saktë për.

3 PY. Ju dhatë, ju keni dhënë dëshmi, keni dëshmuar në çështjen  
4 Eastman rreth vitit 2018?

5 PË. Po.

6 PY. A ju kujtohet në të cilën fazë të gjyimit të procesit ka  
7 ndodhur kjo dëshmi?

8 PË. Cila -- cili proces? Procesi besoj ka qenë rigjykimi i  
9 gjyimit të vitit 1995.

10 PY. Për këtë e kisha fjalën. Ju keni shkruar lidhur me  
11 çështjen Eastman në disa raste, apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe tani ju po thoni që nuk jeni -- nuk keni njohuri të  
14 afërt me faktet e çështjes dhe i keni nevojë t'iu freskohet  
15 kujtesa, t'i freskoni kujtesën vetes?

16 PË. Jam shumë e njohur me faktet e çështjes. Nuk jam e njohur  
17 në hollësi tani, tani që duhet të më kujtohet duhet ta kem  
18 përpara meje, të kem aktvendime gjyqësore lidhur me dëshmitë e  
19 mia në çështjen në përgjithësi.

20 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, do të doja  
21 që të bëja komentin në vijim duke patur parasysh atë që  
22 dëshmitarja sapo tha, që të jemi të drejtë me dëshmitaren. Në  
23 qoftë se Prokuroria dëshiron të bëjë pyetje për aktvendime që  
24 lidhen me herë ekspertizën e saj, do të ftoj ata që t'i  
25 paraqesin dëshmitarit vendimin, aktvendimin në fjalë.

1 Faleminderit.

2 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Përpara që të bëjmë kështu  
3 para-mbrapa, besoj që z. Hafetz këtë po bënte dhe do ta bënte  
4 shpejt.

5 Është kështu z. Hafetz?

6 Z. HAFETZ: [Përkthim] Kështu është, i nderuar Gjykatës,  
7 do të bëj disa, edhe dy pyetje të tjera dhe pastaj do të shfaq  
8 vendimin konkret sepse mendoj që është shumë e rëndësishme  
9 njohuria e dëshmitarit lidhur me çështjen dhe aftësia e saj  
10 për ta përshkruar atë, lidhet me raportin dhe përgjigjen që  
11 dha gjatë seancës së përgatitore.

12 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull. Vazhdoni.

13 Z. HAFETZ: [Përkthim]

14 PY. A e dini sa herë i jeni referuar çështjes së Eastman në  
15 më shumë se 20 artikuj që keni shkruar?

16 PË. Nuk e di.

17 PY. Më shumë se pesë, a e pranoni këtë?

18 PË. Nuk e di.

19 PY. Që të jemi të qartë, çështja e Eastman përfshinte një  
20 keqadministrim, pra, të drejtësisë, apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. Apo ajo që përmendet si keqadministrimi, gabim,  
23 keqadministrimi i drejtësisë, pra, gabim gjyqësor?

24 PË. Po, dhe ky gabim gjyqësor nuk kishte të bënte fare me  
25 provat audio në këtë çështje?

1 PË. Nuk jam e sigurt që kjo është tërësisht e saktë.

2 PY. Si nuk është tërësisht e saktë?

3 PË. Unë thjesht po them se do të kisha preferuar të kisha pak  
4 më shumë -- të isha njoftuar pak më përpara lidhur me këtë  
5 pyetje. Mendoj se ju i referoheni -- asaj që i referoheni  
6 është roli i mbetjeve të të shtënave me armë zjarri, pra,  
7 dëshmive dhe provave lidhur me këtë, dhe provave të tjera që  
8 janë diskutuar në hetimin e 2014-s lidhur me këtë çështje, që  
9 kanë çuar pastaj në rigjykimin e 2018-s. Nuk jam e sigurt se  
10 kujt po i referoheni. Ju po më bëni pyetje dhe unë jam në fakt  
11 pak e humbur. Nuk kam informacion të mjaftueshëm, nuk e njoh  
12 çështjen shumë mirë. Gjithmonë kam qenë më shumë e interesuar  
13 në mënyrën se si audio është trajtuar gjatë gjithë çështjes,  
14 dhe nuk më kujtohet saktësisht se si komentet e mia konkrete  
15 të veçanta, dëshmia ime është trajtuar nga gjykatësi në  
16 hollësi. Nuk besoj se dëshmia ime -- besoj se dëshmia ime ka  
17 qenë e saktë në gjykim, korrekte, dhe mendoj se e ka patur një  
18 ndikim në rezultatin, përfundimin e gjykimit.

19 Edhe më e rëndësishme besoj se dëshmitë e audios, pra, në  
20 gjykimin e parë kanë qenë të rëndësishme në marrjen e  
21 verdiktit, në arritjen e verdiktit, që pastaj është kthyer  
22 mbrapsht për rigjykim në 2018, dhe personi është shpallur i  
23 pafajshëm dhe i është dhënë kompensim, dëmshpërblim.

24 PY. Ka qenë një tjetër ekspert i cili ka dhënë dëshmi në atë  
25 çështje, apo jo?



1 PË. Ka patur disa ekspertë në gjykimin e 1995-s. Nuk kam qenë  
2 njëra prej tyre dhe pastaj ka patur një tjetër në vitin 2018  
3 kur është bërë rigjykimi.

4 PY. Dhe a ju kujtohet kush ka qenë ai person?

5 PË. Po.

6 PY. Kush ka qenë?

7 PË. Profesor Peter French.

8 PY. Dhe ai është ekspert i njohur, i shquar i fushës, apo jo?

9 PË. Po.

10 Z. HAFETZ: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim në  
11 ekran tani SPOE00410930 deri në 961, dhe fillojmë në faqen e  
12 parë për kontekst.

13 PY. Ky është vendim i Gjykatës Supreme të Territorit të  
14 Kryeqytetit të Australisë në çështjen Eastman 2018, apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. A e keni lexuar këtë më parë?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe çfarë është shkruar në të?

19 PË. A e kam lexuar, e keni fjalën për aktvendimin?

20 PY. Çfarë u vendos në të, në këtë çështje?

21 PË. Nuk mund t'ju jap një përgjigje duke parë vetëm faqen e  
22 parë.

23 Z. HAFETZ: [Përkthim] Në qoftë se znj. Sekretare mund të  
24 çojë dokumentin më poshtë të shfaq në ekran pjesën e poshtme  
25 të dokumentit dhe kalojmë në faqen tjetër.

1 DËSHMITARJA: [Përkthim] Po.

2 Z. HAFETZ: [Përkthim]

3 PY. A e keni lexuar këtë më parë?

4 PË. E kam lexuar, sigurisht. Jo kohët e fundit sepse nuk  
5 prisja që të merrem në pyetje për këtë.

6 PY. Dhe ju keni shkruar për pjesë të caktuara të këtij  
7 vendimi?

8 PË. Po, por nuk jam e sigurt, nuk më kujtohet saktësisht  
9 përmbajtja e tij.

10 PY. Por ky proces që rezultoi në këtë vendim që po shohim  
11 tani, ju keni qenë pjesë e tij.

12 PË. Po.

13 PY. Keni dëshmuar me Dr. French?

14 PË. Po.

15 Z. HAFETZ: [Përkthim] Në qoftë se shohim paragrafin 128  
16 që është në dokumentin PDF 129 ERN-ja që përfundon me 958.

17 PY. Këtu gjykata bën jep përmbledhje të përfundimeve të saj?

18 PË. Po.

19 PY. E keni lexuar më parë këta?

20 PË. Po.

21 PË. Në paragrafin 128 thuhet:

22 "Pranoj se Dr. Fraser është e kualifikuar për të dhënë  
23 dëshmi ekspertit lidhur me fonetikën dhe me çështjet që kanë të  
24 bëjnë me përmirësimin, megjithatë dyshoj se qëndrimi i saj i  
25 prerë, dhe në një farë shkalle evangjelic, pikëpamjet e saj

1 lidhur me atë që ajo percepton si dështim nga Gjykata e Lartë  
2 e Butera, me pasojat edhe efektin dëmtues të rëndë mbi  
3 vendimet e shumë gjykatave të apelit dhe gjykatave të tjera në  
4 Australi në 30 vitet e fundit, kanë patur tendencë në një farë  
5 shkalle të ndikojnë në dëshminë e saj."

6 A pranoi këtë që ka -- përfundimin e gjykatës në këtë  
7 vendim?

8 PË. Nuk mendoj se jam i evangjeliste, nuk mendoj që them këtu  
9 që ka patur dështim nga Gjykata e Lartë në Butera. Besoj se ka  
10 një dështim në mënyrën se si gjykatë -- në mënyrën se si  
11 vendimi i Gjykatës së Lartë, pra, Gjykata e Lartë në Australi  
12 e ka zbatuar këtë vendim në çështje të mëvonshme pastaj  
13 gjyqësore, dhe kam shkruar lidhur me këtë.

14 PY. Por ju keni dhënë dëshmi dëshmuat në këtë çështje?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe keni, dhënë një -- dorëzuar një raport?

17 PË. Po.

18 PY. Edhe gjykatësi e ka lexuar atë, mendohet?

19 PË. Mendoj që po.

20 PY. Gjykatësi ka konstatuar, konstaton gjithashtu se:

21 "Ka patur raste gjatë marrjes në pyetje nga pala  
22 jothirrëse e Dr. Fraser ku përgjigjet dukeshin kokëforta dhe  
23 që në disa raste edhe i shmangeshin pyetjes."

24 E keni lexuar këtë më parë?

25 PË. E kam lexuar.

1 PY. Pastaj gjykatësi vazhdon - në qoftë se mund të shkojmë më  
2 tej në faqe, më poshtë - por duke mbajtur këtë pjesën e  
3 paragrafit 128, për të cituar këtu dy shembuj. I keni lexuar  
4 këta më parë?

5 PË. Po.

6 PY. Pra, paragrafi menjëherë sipër paragrafit 129 në pjesën e  
7 dytë, përgjigja juaj është:

8 "Supozoj, pjesërisht sepse nuk e di se ku doni të dilni  
9 me këtë. Ju duket mesa duket ju po më pyesni të pajtohem me  
10 gjëra që nuk po pranoj në asnjë moment."

11 Kjo është e ngjashme me përgjigjen që ju më dhatë mua.

12 PË. Po.

13 PY. Kur konstatoi se përgjigjet tuaja ishin këmbëngulëse dhe  
14 po i shmangeshin pyetjes?

15 PË. Kjo gjykatë?

16 PY. Gjykata për të cilën po flas, që po lexoj.

17 PË. Qartësisht kështu duket.

18 PY. Ju nuk e përmendët në këtë vendim të 2018-s për të cilin  
19 ju keni shkruar kur Mbrojtja e Thapit ju pyeti juve për dëshmi  
20 të mëparshme dhe mënyrën se si janë trajtuar ato?

21 PË. Po, sigurisht që u kam thënë atyre që ka patur edhe  
22 komente, vlerësime negative nga gjykatat dhe këto janë të  
23 dokumentuara, mund të mos kenë shkruar për këtë.

24 Z. HAFETZ: [Përkthim] A mund të paraqesim në ekran, znj.  
25 Sekretare, DHT1201728. Do doja të kalojmë para në ERN 1729,

1 paragrafi 7.

2 PY. Tani që po shohim këtë, Dr. Fraser, për kontekst është  
3 shënimi përgatitur i Mbrojtjes i përgatitur lidhur me takimin  
4 që keni patur me ta me 5 maj. Kjo është përmbledhja e takimit.

5 PË. Kjo është ajo që pamë edhe më herët?

6 PY. Kemi patur, kemi parë pjesë të saj më herët saktësisht.

7 Tani mund të lexoni fillimin e paragrafit 7.

8 PË. Po e lexoj.

9 PY. Në rregull.

10 PË. Po.

11 PY. Tani që jemi këtu, a ka ndonjë -- a përmendet këtu  
12 vendimi në çështjen Eastman?

13 PË. Nuk mendoj që dëshmia ime në këtë rast është hedhur  
14 poshtë. Dëshmia ime është përdorur dhe ka qenë pjesë e  
15 rëndësishme e rezultatit përfundimtar të gjykimit.

16 PY. Pyetja, siç është përmbledhur nga ekipi i Mbrojtjes së z.  
17 Thaçit në fjalinë e parë, ishte se si dëshmia juaj është  
18 vlerësuar?

19 PË. Po.

20 PY. Ky vendim lidhet me mënyrën se si dëshmia juaj është  
21 vlerësuar, apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Dhe ju nuk e keni përmendur asnjë fjalë të kësaj që po i  
24 kthehem pyetjes time tani?

25 PË. Ja kam përmendur këtë çështje atyre. E kam përmendur se

Dëshmitarja: Helen Fraser (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Hafetz (Vazhdim)

Faqe 102

1 ka patur vlerësime negative të dëshmisë sime dhe këto  
2 vlerësime të bëra në linjë.

3 PY. Kur e keni bërë këtë?

4 PË. Në diskutimet tona të mëparshme, të mëhershme. Nuk më  
5 kujtohet saktësisht kur.

6 PY. Është bërë kjo përmes emailit apo bisedave telefonike apo  
7 diku tjetër?

8 PË. Në takimet që kemi patur në platformën Zoom, ndoshta.

9 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Hafetz, është koha për të  
10 bërë pushimin e drekës.

11 Z. HAFETZ: [Përkthim] E kuptoj, i nderuar Gjykatës. Më  
12 kanë mbetur më pak se 40 minuta.

13 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Së pari do të kërkojmë të  
14 shoqërojmë dëshmitarin jashtë, dëshmitaren jashtë.

15 Dr. Fraser, përpara se të hiqni kufjet, do kthehemi në  
16 orën 2.30.

17 DËSHMITARJA: [Përkthim] Faleminderit.

18 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

19 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Së pari dua të them duke u  
20 përgjigjur komentit që u ngrit në kundërshtimin e mëhershëm

21 nga znj. Menegon lidhur me sasinë e kohës që i jepet

22 Prokurorisë për marrjen e pyetjes së dëshmitares së Mbrojtjes,

23 rikujtoj se i është dhënë kohë e konsiderueshme Mbrojtjes për

24 tema teknike të cilat duhet të trajtoheshin, dhe jam i sigurt

1 që këtë e vlerësoni, sepse duhej më shumë kohë ndoshta sesa do  
2 të duhej me një dëshmitar të zakonshëm.

3 Megjithatë duke thënë këtë, z. Hafetz, do uroj që seanca  
4 e ardhshme të jetë shumë efikase, dhe ndoshta mund të arrijmë  
5 në fund të saj për të thënë, për ta mbyllur këtë çështje, për  
6 të folur në mënyrë më të drejtpërdrejtë. Ka dy seanca tani që  
7 po vëzhgoj dhe po shoh këtë dëshmitar dhe jam tërësisht i  
8 informuar për pikat që ju po përpiqeni të vërtetoni duke  
9 treguar deklarata mospërputhëse të mëhershme dëshmitares, për  
10 shembull, gjatë dëshmisë së saj, dhe mendoj duke patur  
11 parasysh sasinë e kohës që ju e keni kaluar duke trajtuar këto  
12 pika mund ndoshta të arrijmë në pikën përfundimtare pak më  
13 shpejt.

14 Z. HAFETZ: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, në këtë çështje  
15 do të them se kjo është ndoshta shumë e rëndësishme. E kuptoj  
16 dhe pranoj atë që thoni dhe do të përpiqem, do të vijoj me  
17 pyetjet e mia në mënyrë sa më efikase që të jetë e mundur, së  
18 pari, duke konstatuar kohën që është dhënë për dëshmitarë të  
19 tjerë. Por, pavarësisht gjithë kësaj ajo që po konstatojmë  
20 pothuajse minutë pas minuti është se ky dëshmitar ka patur  
21 biseda të tjera lidhur me materialin që ka ndikim të  
22 drejtpërdrejtë në raportin e saj dhe që ajo i ka dorëzuar  
23 Gjykatës.

24 Pra, me lejen tuaj, i nderuar Gjykatës, do të vlerësoja  
25 që të më lejohet kjo. Është një fakt i rëndësishëm, për

1 shembull, që dëshmitarja më parë i ka thënë, i ka treguar  
2 Mbrojtjes për trajtimin apo vlerësimin negativ të dëshmisë së  
3 saj në një çështje të caktuar në Australi, dhe kjo është në të  
4 dhëna publike. Ata nuk na e kanë dhënë këtë informacion. Nuk  
5 na kanë informuar. Ne është dashur ta gjejmë këtë informacion  
6 vetë.

7 Pra, dëshiroj dhe mendoj se është e rëndësishme që të na  
8 jepet mundësia të bëjmë pyetje lidhur me këtë, sepse ne po  
9 gjejmë gjithnjë e më shumë informacion që është i rëndësishëm,  
10 dhe kjo po ndodh në kohë reale. Do ta bëjnë në mënyrë sa më  
11 efikase që të mundem, por mendoj që do të jemi në gjendje të  
12 përfundojmë brenda një ore në seancën tjetër.

13 Dhe, të nderuar Gjykatës, diçka më shumë. Është e  
14 rëndësishme të konstatohet gjithashtu se përgjigjet e djeshme  
15 janë të ndryshme dhe ndoshta mund -- kjo është e qartë për  
16 gjykatën që po e vëzhgon këtë proces, por këto duken jo në  
17 përputhje dhe nuk po them që ju po i gjykoni ato, por është e  
18 rëndësishme që të kemi një procesverbal të qartë lidhur me atë  
19 që ajo po thotë, pra, dëshmitarja.

20 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] E kuptoj këtë, z. Hafetz. I  
21 marr parasysh të gjitha këto që po thoni ju dhe i vlerësoj  
22 këto pika. Pres nga juve, megjithatë, që të jeni në gjendje të  
23 përfundoni pyetjet tuaja brenda 45 minutash. Në qoftë se nuk  
24 jeni në gjendje të përfundoni brenda 45 minutash, do pres  
25 parashtime nga ju që kërkon, pra, lidhur me arsye sepse



1 kërkon më shumë kohë.

2 Z. HAFETZ: [Përkthim] E kuptojmë. Në rregull.

3 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Seanca ndërpritet deri në  
4 2.30.

5 Faleminderit.

6 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.03

7 --- Seanca rifillon në orën 14.41

8 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mund të sillni dëshmitarin.

9 Ka ndonjë ndryshim nga palët? Pjesëmarrësit janë të  
10 njëjtë, me sa shoh. Jo? Në rregull.

11 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

12 Mirë se erdhët.

13 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

14 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Një rikujtesë, se ndërkohë  
15 kemi pasur dhe drekën, por ju lutem kujdes të bëni një pauzë  
16 pas pyetjes.

17 DËSHMITARJA: [Përkthim] Do bëj të pamundurën.

18 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Jam i bindur që kjo seancë  
19 do të shkojë shumë mirë.

20 Z. HAFETZ: [Përkthim] Ju lutem, nxirrni në ekran  
21 materialet SPOE00410930. Shkojmë në faqen 959, ju lutem. Ky  
22 është, kjo është çështja Eastman që po diskutonim pak më  
23 herët, vendimi që diskutuam më herët.

24 Në paragrafin 130, shkurtimisht, gjykatësi ka shkruar se  
25 e pranonte se Profesori Braun dhe French ishin të kualifikuar

1 për të dhënë aktekspertizë, edhe ndonëse opinionet e tyre  
2 dallonin prej opinioneve tuaja, gjykatësi ka pranuar dëshminë  
3 e tyre, apo jo?

4 PË. Besoj se kështu kuptohet, po, pavarësisht se nuk  
5 shprehet.

6 PY. Pra, këtu thuhet që ndonëse ju kishit mendim ndryshe nga  
7 profesorët e tjerë, gjykata zgjodhi mendimin e tyre, opinionin  
8 e tyre?

9 PË. Po.

10 PY. Para 3 vjetësh, në 2023, keni shkruar një artikull tjetër  
11 për çështjen Eastman, me titullin "Transkriptet e çështjes  
12 Eastman".

13 PË. Po.

14 Z. HAFETZ: [Përkthim] Shohim në ekran materialet  
15 SPOE00411173.

16 PY. A e njihni këtë?

17 PË. Po.

18 PY. A është ky artikulli?

19 PË. Po.

20 PY. Ky është një prej shumë artikujve që keni shkruar për  
21 këtë çështje, apo jo?

22 PË. Nuk do të thoja shumë në çështjen Eastman, por është një  
23 nga artikujt që kam shkruar unë për çështjen Eastman.

24 Z. HAFETZ: [Përkthim] Shkojmë në faqen e fundit të  
25 dokumentit që mbaron me 201. 201.

1 Dr. Fraser, këtu keni vendosur bibliografinë. Kjo është  
2 vetëm një nga faqet.

3 PË. Po.

4 PY. Në fund, ose shkojmë më poshtë, këtu thuhet "Çështje dhe  
5 legjislativoni i cituar", dhe ka çështje që janë vetëm për  
6 Eastman këtu?

7 PË. Po.

8 PY. Asnjë prej këtyre vendimeve nuk është vendimi i 2018-s që  
9 diskutuam pak më herët, apo jo?

10 PË. Jo. Ky artikull është për çështjen e vitit 1995.

11 PY. E kuptoj, po artikulli flet për zhvillimet dhe zhvillimet  
12 që kanë ndodhur dhe pas 1995-s.

13 PË. Po.

14 PY. Përfshirë këtu edhe një çështje tjetër të Eastman në  
15 vitin 2019, madje, apo jo?

16 PË. Po.

17 PË. Dhe 2014-n, apo jo?

18 PË. Po.

19 PY. Por, këtu mungon çështja e 2018-s, ndonëse në vetë  
20 artikull keni përmendur procesin gjyqësor, keni përmendur që,  
21 në fakt, këtu është gjithçka që i ka paraprirë vendimit të  
22 2018-s.

23 PË. Nuk e kuptova shumë mirë atë, por, po, e pranoj këtë që  
24 po thoni.

25 PY. Në artikull, në fakt, ju keni cituar disa herë çështjen,

1 apo më saktë këto tre vendime dhe nuk keni përfshirë vendimin  
2 e 2018-s që ishte shumë i rëndësishëm për ju, apo ngaqë ju  
3 kritikonte, apo jo?

4 PË. Nuk e kam përfshirë, po jo për arsye se ishte kritik ndaj  
5 meje.

6 PY. E kuptoj.

7 Z. HAFETZ: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin.

8 PY. Tani dua të fokusohemi te çështja e Michael Clark që u  
9 përmend dje.

10 PË. I nderuar Gjykatës, a mund të them unë diçka lidhur me  
11 këto vendimin që sapo hoq nga ekrani? Sepse e pashë gjatë  
12 pushimit të drekës, dhe ka disa gjëra që do doja t'i sqaroja  
13 nëse është e mundur.

14 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Profesore Fraser, për  
15 momentin ne do të vazhdojmë me pyetjet, por kini parasysh që  
16 do t'jua japim mundësinë, dhe këtë mund ta thoni më vonë. Do  
17 t'ju japim mundësi ta thoni.

18 Z. HAFETZ: [Përkthim]

19 PY. Unë synoj që të kërkoj për pranim këtë çështje, bashkë me  
20 materialet e tjera që do t'i rendis në fund. Është synimi im  
21 që Gjykata të ketë dokumentet. Pra, Gjykata do të ketë  
22 vendimin që përmendet më herët.

23 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Hafetz, a do donit ju që  
24 dëshmitarja ta shprehte tani pikëpamjen e saj apo do të  
25 parapëlqenit që ta trajtojë në fund të seancës?

1           Z. HAFETZ: [Përkthim] Për shkak të kufizimit që kam me  
2 kohën, do të parapëlqejë që të bëhej në fund kjo gjë.

3           ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Unë do të doja që kolegu të na  
4 thotë sa herë që vendos një dokument në ekran nëse synon që  
5 këto dokumente të pranohen si prova gjyqësore.

6           Z. HAFETZ: [Përkthim] Atëherë po ju them që tani që të  
7 gjithë dokumentet që do të paraqes tani do të kërkohen si  
8 prova gjyqësore.

9           PY. Keni punuar në çështjen e Michael Clark?

10          PË. Po.

11          PY. Dhe i jeni referuar shpesh çështjes së Michael Clark. Për  
12 shembull, në artikullin tuaj keni folur se sa i rëndësishëm  
13 është ekspozimi i kontekstual dhe interpretimi se si -- sepse  
14 keqinterpretimi të çon në shpallje fajësie.

15          Edhe se si, sa e rëndësishme është gjuha, dhe fjala cenon  
16 -- tani në gjykimin e 2018-s, z. Clark, z. Michael Clark u  
17 dënua për vrasjen e babait të tij. Edhe ishte i biri ai që e  
18 tërhoqi këmbëzën e armës.

19          PË. Po.

20          PY. Përveç provave të tjera që u paraqitën në atë çështje  
21 gjyqësore ishin dhe disa incizime të fshehta?

22          PË. Po.

23          PY. Dhe në transkript përfshiheshin frazat, citoj, "në fillim  
24 bëmë një pakt"?

25          PË. Po.

1 PY. Pas disa apelimeve të pasuksesshme, juve ju dhanë disa  
2 prej incizimeve të fshehta, apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Kjo ka ndodhur rreth shtatorit 2011, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Këto incizime dhe transkriptet ua dha një person që quhej  
7 Jenny Clark, apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. Çfarë lidhje kishte ajo me Michael Clark?

10 PË. Ishte bashkëshortja.

11 PY. Kjo çështje ishte e goxha e njohur në Australi, apo jo?

12 PË. Ishte shpesh në gazeta, po.

13 PY. Ju i ekzaminuat incizimet dhe transkriptet që ju dha  
14 gruaja të pandehurit për disa vite, apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe përfundimisht ju i kërkuat leje familjes që t'i  
17 përdorni këto incizime për disa eksperimente akademike, apo  
18 jo?

19 PË. Po.

20 PY. Këto eksperimente, në fakt, u përfshinë dhe në një nga  
21 artikujt që përmenda më herët kur kishit folur për "Pushtetin  
22 që ka ekspozimi apo ndikimin që ka ekspozimi kontekstual".

23 PË. Po.

24 Z. HAFETZ: [Përkthim] Për procesverbal është

25 SPOE00411125-20411149.

1 PY. Pas kësaj shkruat një raport që u përdor për të

2 mbështetur rishikimin e dënimit të z. Clark?

3 PË. Po.

4 PY. Dhe qëllimi kryesor i raportit është që të prapësohej

5 vendimi i fajësisë bazuar në prova të reja që kishin dalë?

6 PË. Ishte kërkesë për rishikim të vendimit të fajësisë të

7 dënimit.

8 PY. E shkruat këtë raport për gjykatën tre vjet pasi ua

9 kishte dhënë audioincizimet familja e të pandehurit?

10 PË. Po.

11 PY. Kur znj. Clark ua dha incizimet, kasetat, synimi ishte që

12 të ndihmonte bashkëshortin, apo jo?

13 PË. Ma merr mendja që po.

14 PY. Po ju e dini pse ua dha, apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. Pse?

17 PË. Besoj për të ndihmuar bashkëshortin.

18 PY. Kur thoni "supozoj", doni të thoni që nuk e dini dhe po

19 supozoni apo e dini me siguri?

20 PË. Për këtë mund të pyesni znj. Clark. Unë besoj se po e

21 bënte për të ndihmuar bashkëshortin.

22 PY. Po vetë ua tha shprehimisht ajo ju këtë gjë?

23 PË. Nuk më kujtohet. Kanë kaluar shumë vite. Jo, më tha

24 diçka. Më tha diçka.

25 PY. Më lejoni të përfundoj pyetjen. Thjesht ua dha këto

1 incizime kot për interes personal?

2 PË. Jo.

3 PY. Po çfarë ju tha, pra, kur ua dha?

4 PË. Nuk më kujtohen fjalët tamam, po përshtypja që pata unë  
5 dhe supozimi im ishte që ajo nuk ishte e kënaqur apo nuk ishte  
6 dakord me mënyrën se si ishte zhvilluar gjykimi i  
7 bashkëshortit të saj, edhe donte që të rishikoheshin njëherë  
8 këto incizimet.

9 PY. Pra, të shiheshin incizimet me synim ndryshimin e  
10 vendimit, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Në gjykimin e parë, mbrojtja këmbëngulte që fjala "pakt"  
13 ishte në incizim, thuhej në incizim. Por ajo që nuk ishte e  
14 qartë ishte çfarë nënkuptonte ky pakt. Këtu nuk kishte  
15 dakordësi mes palëve?

16 PË. Po.

17 PY. Në studimet tuaja dolët në përfundimin se sipas jush nuk  
18 përmendej fjala "pakt".

19 PË. Jo vetëm fraza, jo vetëm fjala pakt, më falni, e gjithë  
20 fraza, e gjithë fraza që kur thuhej "kishim pakt". "Kishim  
21 pakt".

22 PY. Fraza ishte "Në fillim kishim pakt". Domethënë ju thoni  
23 që nuk është thënë fare kjo, që nuk ishte në incizim?

24 PË. Po.

25 PY. Ndryshe nga qëndrimi që kishte mbrojtja gjatë gjykimit,



1 apo jo?

2 PË. Po.

3 Z. HAFETZ: [Përkthim] Shohim materialin SPOE00410901, ju  
4 lutem.

5 PY. Profesore, për të kuptuar kontekstin ky është një  
6 dokument që kemi parë shumë shkurtimisht dje. Sidoqoftë ky  
7 është vendimi i Gjykatës Supreme të New South Wales i 2015-s.  
8 E njihni?

9 PË. Po.

10 PY. E njihni nga titulli apo donit të shikoni dhe  
11 përmbajtjen?

12 PË. Ky është vendimi që ka hedhur hije dyshimi mbi dëshminë  
13 time, mbi provat e mia.

14 Z. HAFETZ: [Përkthim] Shkojmë te materiali ERN 908.

15 PËRKTHYESJA: Një korrigjim i përkthyesit: Thuhet "Është  
16 vendimi që ka trajtuar provat e mia".

17 Z. HAFETZ: [Përkthim]

18 PY. E keni lexuar më përpara këta?

19 PË. E kam lexuar, po dëshiroj ta shikoj edhe pak.

20 PY. Në rregull.

21 PË. E lexova.

22 PY. Në këtë paragraf gjykata diskuton një pjesë të dëshmisë  
23 që keni dhënë ju në këtë çështje, përfshirë pikëpamjet tuaja  
24 lidhur me ekspozimin kontekstual dhe si u zbatua në këtë  
25 çështje gjyqësore.

1 PË. Po.

2 PY. Përfundimisht kërkesa u rrëzua, apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Gjykata nuk konstatoi asnjëherë që fraza që kontestuat ju  
5 nuk ishte në incizim?

6 PË. E keni fjalën trupi gjykues? Në atë rast ishte -- nuk  
7 ishte gjykata, ishte thjesht një gjykatë, një gjykatës i  
8 vetëm. Nuk e di çfarë doni të thoni. Mund ta sqaroni?

9 PY. Gjykata Supreme kur e lëshoi këtë vendim në 2015, 25  
10 gusht 2015, a konstatoi se, në fakt, fraza që thuhej, "Në  
11 fillim bëmë një pakt" ishte apo nuk ishte në incizim?

12 PË. Jo, nuk besoj se Gjykata Supreme e pranoi këtë.

13 PY. Kur thoni "besoj se nuk e pranuan", e dini me siguri apo  
14 jo?

15 PË. Tani do duhet ta lexoj dhe një herë vendimin. E di që  
16 vendimi u rrëzua dhe nuk e pranoi faktin që kjo frazë nuk  
17 ekzistonte. Por më jepni një çast ta shikojmë në qoftë se  
18 është nevoja.

19 PY. Në rregull.

20 PË. Po në përgjithësi nuk e pranoi dëshminë time trupi  
21 gjykues.

22 PY. Dhe asnjë konstatues faktesh nuk ka rënë dakord me  
23 përfundimet tuaja në atë çështje, apo jo?

24 PË. Besoj që është i vetmi rast. Unë s'kam qenë e përfshirë  
25 gjatë gjyimit. Me sa kam ndjeni ky është i vetmi person që e

1 ka lexuar dëshminë time.

2 PY. Po e them dhe një herë. Asnjë konstatues faktesh në

3 Australi, askush nuk ka thënë që fraza nuk është thënë?

4 PË. Kjo frazë konkrete? Po vetëm një konstatues faktesh ka

5 qenë i përfshirë, që mund të binte ose mund të mos binte

6 dakord, apo jo?

7 PY. Po kanë qenë dy konstatues faktesh.

8 PË. Po s'kam dhënë mendime unë në gjykimin e parë, pra.

9 PY. Pra, një konstatues -- atëherë konstatues i fakteve nuk u  
10 pajtua me përfundimin tuaj dhe u rrëzua kërkesa, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Sidoqoftë ju i referoheni kësaj fraze. Në shkrimet tuaja  
13 keni thënë që kjo frazë, në fakt, përfundimi që ka dalë lidhur  
14 me këtë frazë ka qenë i pasaktë.

15 PË. Mendoj se fraza ka qenë e pasaktë. Nuk e di nëse e kam  
16 përmendur që, në fakt, konstatimi ka qenë i pasaktë. Nuk më  
17 kujtohet.

18 PY. Asnjë nga artikujt që përmendëm, dhe unë po deshe t'i  
19 lexoj sërish, lidhur me çështjen e këtij "pakti", nuk e  
20 citojnë vendimin, këtë vendim, apo jo?

21 PË. Një, po. Një e diskuton, e përmend vendimin.

22 PY. Bashkë me citimet përkatëse apo thjesht e përmend në vija  
23 të përgjithshme?

24 PË. Nuk më kujtohet nëse i kam dhënë citimet përkatëse, por e  
25 di që e kam përmendur dhe kam komentuar në një nga këto

1 artikuj.

2 PY. Kur folët me ekipin e Mbrojtjes së z. Thaçi pas kërkesës  
3 që ju bënë ata se si janë trajtuar dëshmitë tuaja në të  
4 shkuarën, a e përmendët edhe këtë çështje?

5 PË. Jo, ju e ngritët çështjen e Eastman dhe Clark, dhe ekipi  
6 i Mbrojtjes së z. Thaçi më pyeti në lidhje me këto dhe u  
7 thashë që ka pasur disa ë vendime që nuk kanë qenë në favorin  
8 tim në lidhje me këtë.

9 PY. Nuk ju bëra unë këtu pyetje. Unë po ju pyes a e keni  
10 informuar Mbrojtjen e Thaçit lidhur me këtë?

11 PË. Po.

12 PY. Kur e keni bërë këtë?

13 PË. Gjatë diskutimit që ju përmendët më herët. Nuk më  
14 kujtohet data e saktë.

15 PY. Unë s'kam përmendur asnjë diskutim. Për të cilin diskutim  
16 po flisni?

17 PË. Kemi folur në një moment lidhur me këtë, sepse ishte  
18 përmendur në një nga dokumentet ku thatë që keni pasur një  
19 korrespondencë me email lidhur me këtë me ekipin e Mbrojtjes  
20 së z. Thaçi.

21 PY. Po çfarë i thatë ju Mbrojtjes së z. Thaçi kur doli kjo  
22 çështje?

23 PË. Mesa më kujtohet ju kishit -- ju i kishit paraqitur këto  
24 dy çështje gjyqësore dhe unë u thashë, "Po, kështu është". Në  
25 këtë rast ka qenë gjetje jo në favorin tim. Nuk më kujtohet

1 saktësisht çfarë u kam thënë, por, në të dyja këto dy çështje  
2 unë mendoj -- akoma mendoj që kam pasur të drejtë, kështu që  
3 kjo lidhet me atë që u diskutua pak më herët. Ndonjëherë edhe  
4 konstatuesit e fakteve bëjnë gabime. Unë besoj të paktën në  
5 këtë rast kështu ka qenë.

6 PY. Pra ju po thoni për këto dy çështje që ju pyeta sot që  
7 gjykata e ka pasur gabim dhe ju keni pasur të drejtë?

8 PË. Po.

9 Z. HAFETZ: [Përkthim] Shohim në ekran materialin që  
10 përfundon me 1722.

11 PY. Për kontekst ky është artikulli, "Transkriptimet  
12 forensike", se si thoni "ekspozimi ndikon në të në gjykimet e  
13 drejta në Australi". Dhe një herë, kjo është. Ehe një herë: "  
14 Transkriptimet forensike: se si besimet e rreme rreth gjuhës  
15 dhe fjalës kërcënojnë të drejtën për gjykim të drejtë në  
16 Australi".

17 PË. Po.

18 Z. HAFETZ: [Përkthim] Të shkojmë tani në faqen 156 me  
19 faqen 56 -- në 590 në PDF.

20 PY. Në mes të faqes ju keni folur për faktin që juria ka dalë  
21 me një vendim, dhe se si në të vërtetë nuk e dini se si e merr  
22 një vendim juria në qoftë se nuk je pjesë e kësaj jurie.

23 PË. Po.

24 PY. Më pas thoni:

25 "... personalisht unë di shumë raste, një prej të cilëve

1 është pjesë e jurisprudencës më poshtë, që në këtë rast nga  
2 transkriptet të gabuara nga policia janë pranuar dhe çuan në  
3 një padrejtësi të mundshme apo faktike.”

4 PË. Po.

5 PY. Rasti që përmendni ju më poshtë është rasti Clark, apo  
6 jo? Për këtë fjalën “pakt”.

7 PË. Po.

8 PY. Ju këtu thoni “dukshëm i pasaktë”, apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. “Dukshëm i pasaktë” për ju, si person, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Jo për gjykatën, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe është dukshëm i pasaktë në këtë rast pasi u është  
15 dhënë një incizim nga bashkëshortja e të pandehurit që ta  
16 ndihmonit këtë person, por ama asnjëherë nuk u prapësua  
17 vendimi, apo jo?

18 PË. Asnjëherë nuk u prapësua vendimi.

19 PY. Për procesverbal, ju besoj se e dini që në atë çështje ka  
20 pasur dhe prova të tjera ku u mbështet trupi gjykues për të  
21 mbështetur vendimin e fajësisë apo jo?

22 PË. Ka pasur prova të tjera që nuk kanë qenë aq të forta sa  
23 çka ka qenë kjo frazë.

24 PY. Nga e dini ju sa të forta apo të forta janë këto prova  
25 dhe se i ka vlerësuar juria?

1 PË. Jo, nuk e di se si i ka vlerësuar juria këto prova.

2 PY. A mund të themi që në shumicën e shkrimeve që keni bërë  
3 për këtë çështje ju nuk e përmendni emrin e çështjes  
4 gjyqësore?

5 PË. Po.

6 Z. HAFETZ: [Përkthim] Do të doja të shihnim tani  
7 shkurtimisht provën që nuk mund ta shihnim këtë paradite sepse  
8 kishim ERN gabim. Ju kërkoj ndjesë për këtë. SPOE00412795.

9 PY. Profesor Fraser, ky është Kodi i Etikës, që unë për po  
10 përpiqesha t'ua tregoja më herët i IAFPA-së. Besoj se ju e  
11 njihni këtë praktikë, e keni parë më përpara, apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe e vlerësoj dhe mendoni që duhet ta respektoni kur  
14 shkruani një raport?

15 PË. Po.

16 PY. Shkojmë më poshtë në faqe. Dua të fokusohem në tre pjesë  
17 dhe më pas do të vazhdojmë. 2.2 pra 2.3.

18 Do përpiqem të ngadalësohem se po e bëj po e bëj pak të  
19 vështirë punën.

20 Do fokusohemi në tre paragrafë në faqen e parë 2.2, 2.3,  
21 2.4. Ju lutem, lexojeni dhe më thoni kur të keni përfunduar.

22 PË. 2.2, 2.3, 2.4? 2.2, 2.3, 2.4?

23 PY. 2.5, në fakt, 2.5.

24 PË. Po, i lexova.

25 PY. I keni njohur kur keni përgatitur raportin?

1 PË. Po.

2 PY. Jam në faqen e fundit. Shohim konkretisht 3.8 dhe 3.9.

3 Unë po i lexoj.

4 3.8 thotë si në vijim:

5 "Rekomandohet që anëtarët të kryejnë analizat e tyre dhe  
6 raportet me shkrim të cilat rishikohen nga një analist i dytë  
7 që ka ekspertizën përkatëse. Sidoqoftë, pranohet se nuk është  
8 e mundshme në të gjitha situatat."

9 Besoj se këto dispozita e njihni apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Pavarësisht këtij rekomandimi, raporti juaj në këtë rast  
12 nuk u rishikua nga asnjë koleg, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. 3.9 thotë:

15 "Kur kryhet analizë fonetike forensike e fjalës në një  
16 gjuhë për të cilën analisti nuk ka kompetencat që do të kishte  
17 një vendas, anëtari duhet të kërkojnë ndihmë nga një folës i  
18 gjuhës në fjalë me përvojë."

19 A ju kujtohet kur i keni kërkuar znj. Menegon ju ndihmë  
20 për gjuhën?

21 PË. Po.

22 PY. Kur?

23 PË. Pothuajse në fillim.

24 PY. Domethënë në janar?

25 PË. Mbase në janar, mbase në shkurt i kam kërkuar ndihmë.



1           Z. HAFETZ: [Përkthim] I kërkoj Sekretares të paraqesë në  
2   ekran dokumentin SPOE41150. Të kalojmë në faqen tjetër të  
3   këtij dokumenti. Të kalojmë tek faqja që përfundon me 153.  
4   PY.   Profesor Fraser, në këtë artikull ju shkruani që -- mund  
5   ta lexoni pjesën përkatëse që lexova në artikull që keni  
6   përpara. E lexuat?  
7   PË.   Po.  
8   PY.   Ju mendoni që gjykata duhet të ndjekë përfundimin që keni  
9   ju në raportin tuaj, apo jo?  
10   PË.   Po. Besoj që, i nderuar Gjykatës, do marrë parasysh atë  
11   çfarë kam dhënë unë si përfundim të raportit.  
12   PY.   Pavarësisht nga fakti që ju nuk e kuptoni shqipen fare?  
13   PË.   Mendoj që kufizimet e mia i kam bërë shumë të qarta në  
14   raport.  
15   PY.   Domethënë, pavarësisht nga fakti që nuk keni marrë mbi  
16   90% të incizimeve në audio të shumë orëve, dhe pavarësisht  
17   faktit që nuk e dini shqipen, ju mendoni që përfundimet tuaja  
18   duhet të merren parasysh, apo jo?  
19   PË.   Besoj që i kam dhënë përgjigje shumë herë me shumë  
20   qartësi kësaj pyetje.  
21   PY.   Edhe tani që e dini se cilat materiale nuk keni marrë,  
22   prapë i qëndroni të njëjtës qëndrimi, apo jo?  
23   PË.   Nuk e kuptova çfarë më thatë.  
24   PY.   Më herët në dëshmi ju thatë që nuk ishit e sigurt në  
25   qoftë se ekipi i Thaçit ju ka dhënë materiale më shumë sesa

1    materialet që ju i keni shënuar në raport, apo jo?

2    PË.    Mendoj që materialet në audio, pra, të audioincizuar  
3    janë dhënë në raport. Nuk është se më kujtohen të gjitha, por  
4    gjithsesi, informacione të cilat i kam marrë parasysh në  
5    raportin tim janë dhënë në raport.

6    PY.    A nuk ju kujtohet që e thatë sot paradite që mbase ju ka  
7    dhënë Mbrojtja e Thaçit më shumë materiale sesa keni  
8    regjistruar në raportin tuaj?

9    PË.    Mendoj që keni të drejtë në atë çfarë thoni, por unë kam  
10    rishikuar një numër shumë të kufizuar të materialeve që lidhen  
11    me këto dy vizita. Vetëm këto kam parë unë.

12    PY.    A nuk ju kujtohet që patëm një bisedë të gjatë e të gjerë  
13    lidhur me dokumentet e tjera të cilat mbase Mbrojtja e Thaçit  
14    ja u ka dhënë dhe ju nuk i keni pasqyruar në raport, si për  
15    shembull Vendimi mbi Gjuhën e Punës?

16    PË.    Ju kërkoj ndjesë, unë mendova që e kishit fjalën për  
17    videoincizimet për audioincizimet. Sepse për sa i takon  
18    Vendimit për Gjuhët e Punës vendimi është shkuar në një gjuhë  
19    që unë e kuptoj shumë mirë.

20    PY.    Jo pyetja ishte më e gjerë.

21    PË.    Në rregull. Në qoftë se e formuloni kështu atëherë  
22    pajtohem.

23    PY.    Po ju e thatë më herët sot që keni marrë dhe  
24    informacionin se materiale të tjera të incizuar në audio që  
25    nuk i keni dëgjuar dhe transkriptet e cilëve juve nuk i keni

Dëshmitarja: Helen Fraser (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Hafetz (Vazhdim)

Faqe 123

1 hapur, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Përsëri pyetja është kjo: Ju po i kërkonit Gjykatës që të  
4 marrë parasysh përfundimet e raportit tuaj pavarësisht kaq  
5 mangësive të mëdha të këtij raporti, apo jo?

6 PË. Unë shpresoj që Gjykata të marrë parasysh raportin tim  
7 sepse unë mendoj që argumentet dhe informacionet që kam dhënë  
8 në atë raport janë shumë relevante për çështjen gjyqësore dhe  
9 të besueshme. Mendoj se e kam bërë të qartë, e kam bërë të  
10 qartë për të gjithë kufizimet që kam pasur, dhe jam përpjekur  
11 që të jem shumë e qartë gjithashtu lidhur me atë çfarë unë  
12 dëshiroj që ta quaj kontribut pozitiv.

13 PY. Dhe vazhdoni që të keni këtë vlerësim pavarësisht që nuk  
14 ishit në gjendje që të thoni që çfarë versioni ose çfarë  
15 versioni të inteligjencës artificiale keni përdorur për të  
16 përfunduar vlerësimin?

17 PË. Jo, unë i di versionet, ja u thashë.

18 PY. Ju thatë emrat po jo versionet, apo jo?

19 PË. Jo, i di versionet, i di versionet.

20 PY. E keni fjalën për ChatGPT-5, apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. Pavarësisht që një gjykatë ju ka konstatuar ju si evazive  
23 dhe oportuniste, ju prapë mendoni që ju duhet që të merreni  
24 seriozisht në përfundimet tuaja?

25 PË. Unë e kundërshtoj këtë. Unë nuk mendoj fare që kam qenë

1 evazive. Nuk kam qenë as evangjeliste në atë çfarë kam thënë,  
2 por mendoj që kam thënë argumentet e mia. Sa i takon këtyre dy  
3 çështjeve gjyqësore të cilat ju i keni cituar, gjykata nuk i  
4 ka pranuar parashtimet e mia. Megjithatë më duhet të them që  
5 kërkesat për rishikimin e vendimeve gjyqësore në -- janë  
6 gjithmonë më tepër, domethënë, janë më të pakta. Dhe kam  
7 përshtypjen që mund të numëroni me gishtat e dorës numrin e  
8 vendimeve gjyqësore ose çështjeve të cilat janë të rihapura  
9 për rishqyrtim të vendimeve përfundimtare të gjykatës. Kështu  
10 që kjo në vetvete nuk tregon asgjë. Domethënë, këto dy vendime  
11 që ju cituat nuk duan të thonë asgjë për ekspertizën time.

12 PY. Faleminderit. Nuk kam pyetje për ju më, Profesore.

13 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, z. Hafetz.

14 Z. Hafetz, përpara se të vazhdojmë më tej dua t'ju pyes  
15 në qoftë se keni ndonjë listë dokumentesh për të cilat kërkon  
16 një numër provizor prove materiale. Ndoshta mënyra më e  
17 shpejtë është që ose t'i lexoni tani ose mund t'i dërgoni për  
18 Zyrën Administrative dhe duke informuar të gjithë palët e  
19 tjera, në mënyrë të tillë që të fitojmë kohë.

20 Z. HAFETZ: [Përkthim] Nuk është problem, unë kam njerëz  
21 të dokumenteve këtu dhe do ja dërgoj të gjithë palëve dhe  
22 Zyrës Administrative.

23 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Keni pyetje plotësuese,  
24 znj. Menegon?

25 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, kam

1 pyetje.

2 Pyetje vijuese nga znj. Menegon:

3 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

4 PY. Mirëdita, Profesore Fraser. Kam disa pyetje për ju që  
5 janë pyetje plotësuese.

6 PË. Nuk e di në qoftë se mund të flisni pak më afër  
7 mikrofonit për t'ju dëgjuar pak më mirë.

8 PY. Është më e qartë tani?

9 PË. Po, tani është më mirë.

10 PY. Ju bënë disa pyetje sa i takon çështjes Clark dhe  
11 Eastman. Sa i takon pyetjes Clark gjykatësi ka njohur efektin  
12 nxitës apo jo?

13 PË. Në të dyja rastet është e njohur ky efekt.

14 PY. Por, në çështjen Clark, gjykatësi e ka njohur ekspertizën  
15 tuaj në fonetikë apo në linguistikë? Është e saktë kjo?

16 PË. Po.

17 PY. Ju thoni që në artikullin tuaj jo domosdoshmërisht ju i  
18 referoni specifikisht çështjes Clark. A ka ndonjë arsye pse  
19 nuk e keni bërë këtë dëshmitare?

20 PË. Kjo ishte për të respektuar familjen që kishte vuajtur  
21 shumë gjatë gjithë procesit gjyqësor, dhe z. Clark ishte ndarë  
22 nga jeta ndërkohë. Unë asnjëherë nuk e kam fshehur emrin, por  
23 thjesht nuk doja të isha e drejtpërdrejtë thjesht për të mos  
24 lënduar familjarët, për këtë arsye.

25 PY. E kuptoj. Gjithashtu ju bënë pyetje lidhur me respektimin

1 e Kodit të Etikës. Më konkretisht, Prokurori ju pyeti lidhur  
2 me faktin që nuk keni pasur ndihmën e një folësi të gjuhës  
3 shqipe që do t'ju ndihmonte që të bënit krahasimet më të mira  
4 dhe do ju jepte ndihmë të mëtejshme lidhur me punën.

5 Pse mendoni ju që e keni respektuar kodin edhe pse nuk  
6 jeni ndihmuar nga një folës i gjuhës shqipe?

7 PË. Unë sigurisht që besoj që kam respektuar të dy kodet që i  
8 përmendi Prokurori. Sigurisht që kam qenë pjesë e hartuesve të  
9 kodit të sjelljes në këtë aspekt. Unë nuk e kam analizuar  
10 gjuhën në audioincizimet, por ka ndodhur në të shkuarën që  
11 persona të caktuar të kenë bërë analiza dhe incizimeve në  
12 audio dhe të folurit që ata nuk e kanë kuptuar. Unë e kam  
13 thënë shpesh herë dhe po e them dhe një herë që unë nuk e kam  
14 analizuar gjuhën. Këtë e kam bërë të qartë që në fillim, dhe  
15 sa herë më është dhënë mundësia e kam theksuar që unë nuk e  
16 flas shqipen dhe jam e kufizuar në këtë aspekt, pra, në  
17 aspektin gjuhësor.

18 Pra, mua më është kërkuar të jap mendimin tim prej  
19 eksperte lidhur me natyrën e incizimet në audio dhe mundësinë  
20 për transkripte të besueshme të materialeve që janë në  
21 incizimet në audio dhe i qëndroj çdo gjëje që kam thënë në  
22 raport.

23 PY. Ju thatë, në fakt, në një moment që do të donit të thoni  
24 diçka më tepër lidhur me çështjen Eastman. Nuk e di në qoftë  
25 se doni të shtoni diçka, në qoftë se doni që të shpjegoni

1 diçka lidhur me këtë çështje.

2 PË. Faleminderit. Nuk e di në qoftë se mund të vazhdoj, z.

3 Gjykatës.

4 Pra, është kënaqësi të dëgjoj që do të keni aktgjykimin e  
5 plotë për ta lexuar, megjithatë, citimet që u bënë nga  
6 Prokuroria ishin shumë të përzgjedhura. Ndërkohë që në atë  
7 gjykim ka pasur gjëra shumë herë më shumë në favorin tim të  
8 thëna.

9 Megjithatë, ajo çfarë është e rëndësishme për t'u  
10 theksuar për momentin, dhe që dua ta ndaj me ju, është që unë  
11 jam e vetmja nga të gjithë ekspertët e tjerë në këtë çështje,  
12 dhe gjykatësit -- më lejoni ta shpreh ndryshe.

13 Problemi në atë aktgjykim kishte të bënte me faktin në  
14 qoftë se përforcimi do kishte çuar në përmirësimin e cilësisë  
15 së incizimeve në audio. Domethënë në këtë aspekt m'u kërkua  
16 mua opinionin. Pra, kishte tre grupe të ndryshme ose tre  
17 elementë të ndryshëm të përforcimit.

18 Të gjithë thonin që këto elementë të përforcimit teknik  
19 kishin çuar në incizimet audio që ishin më të qarta. Gjykatësi  
20 konstatoi se kishte mundësi që të dëgjonte fjalët që ishin  
21 pasqyruar në transkriptin e prokurorisë.

22 Unë bëra një test empirik për të parë se sa të ndryshme  
23 ishin incizimet në audio, domethënë, tri përforcimet dhe  
24 versionin origjinal, dhe e pashë, e vlerësova se sa e vështirë  
25 apo sa e lehtë ishte që të dëgjohej kjo fraza inkriminuese që

1 në fakt ishte thelbi i diskutimit. Dhe testi empirik që bëra  
2 unë më bindi plotësisht që opinionimi im ishte opinionimi i duhur,  
3 i drejtë. Pra, mendoj që duhet bërë dallimi midis, pra,  
4 gjykimit të gjykatave vendimeve të gjykatave dhe konstatimeve  
5 shkencore dhe studimeve shkencore dhe analizave të tjera  
6 shkencore. Domethënë këto janë dy lëmi të veçanta.

7 PY. Në rregull.

8 PË. A mund të them dhe diçka tjetër? Sa i takon Clarkut,  
9 domethënë, çështjes për Clark, vendimit të aktgjykimit për  
10 çështjen Clark, unë nuk e kam lexuar të plotë atë aktgjykim,  
11 por e mendoj që për sa i takon kësaj çështje gjyqësore është e  
12 vërtetë që e gjithë gjykata, përfshirë këtu dhe mbrojtja që  
13 fraza ose formulimi në fillim fare, pra, që "kemi bërë një  
14 pakt bashkë", u dëgjua, ishte thënë ishte diçka e cila ishte  
15 shkëmbyer midis dy folësve. Pra, ka elementë të ndryshëm në  
16 vendim të cilat unë i kam komentuar në artikullin që e tregoi  
17 Prokurori.

18 Por një gjë tjetër që ishte në artikull dhe që nuk mendoj  
19 që e nxori në pah Prokurori, dhe kjo më kujtoi për një çështje  
20 të mëparshme ku kam qenë përfshirë dhe ku gjykatësi e pranoi  
21 opinionin tim dhe ekspertizën time, është një çështje që quhet  
22 Murrel, që është çështje e 2001-shit. Arsyeja që pse m'u  
23 kujtua kjo dhe pse bëra lidhjen e kësaj çështje me fjalën pakt  
24 -- ju kërkoj ndjesë.

25 PY. Mund të pini pak ujë, në qoftë se doni.



1 PË. Atëherë, arsyeja që pse m'u kujtua kjo çështje, pra, edhe  
2 kjo çështje kishte të bënte me ë incizime audio të fshehura.  
3 Dikush ishte dënuar, kishte marrë një vendim fajësie, pra,  
4 ndërkohë unë isha eksperte nga prokuroria, dhe vendimi i  
5 fajësisë mbështetet në faktin që transkripti ishte i gabuar.  
6 Më pas, më duhet të them që lidhja ndërmjet kësaj çështje dhe  
7 çështjes Pakt, është që transkripti i policisë na moral 2001  
8 ishte i njëjti detektiv që kishte dhënë transkriptin për  
9 çështjen Clark.

10 Mendoj që ka një çështje shumë të rëndësishme këtu, dhe  
11 është një çështje të cilën kam kohë që dua ta shtjelloj këtu,  
12 sepse të paktën në disa çështje gjyqësore përdorimi i këtyre  
13 provave nga gjykata nuk është ideal, dhe ka pasur mosvënie në  
14 vend të drejtësisë për shkak të përdorimit të gabuar të  
15 transkripteve të tilla. Kaq dua të them për momentin.

16 Mendoj se më është pasqyruar një qasje shumë negative,  
17 dhe mendoj që Prokuroria ka qenë shumë kritike lidhur me  
18 cilësinë e punës që kam bërë unë brenda gjykatës dhe jashtë  
19 gjykatës, dhe një gjë e tillë nuk është e drejtë.

20 PY. Faleminderit. Thatë më herët sot, në faqen 57 të  
21 transkriptit, se informacioni i brendshëm në audio si të tilla  
22 si emrat mund të jenë të dobishëm për identifikimin e folësve,  
23 por thatë që ka edhe kufizime. A mund të na thoni se çfarë  
24 kufizimesh kishit parasysh kur e thatë këtë gjë?

25 PË. Domethënë, e para është në qoftë se emrat janë

1 transkriptuar siç duhet ose jo, domethënë në mënyrë të saktë  
2 dhe të besueshme. Mendoj që e thashë dhe më përpara sepse kam  
3 folur në disa çështje ku duhej të caktohej se kush ishte  
4 folësi, ku na janë dashur *spreadsheet* të mëdhaja, të gjitha  
5 llojet e faktorëve, pra, duhet të merren parasysh njohuri  
6 faktorësh për të përcaktuar se kush ishte personi. Një pjesë e  
7 punës time kishte të bënte me emra të përdorura dhe të  
8 pranuara, dhe kjo është diçka e rëndësishme. Por, njerëzit  
9 mund të bëjnë gabim ose mund të përdorin emrin e gabuar për  
10 një arsye ose për një tjetër. Kështu që nuk mjafton vetëm  
11 thjesht emri, duhen parë edhe faktorë të tjerë për të  
12 konstatuar me vërtetësi se kush është personi.

13 PY. Ju konfirmuat sot në përgjigje të ZPS-së, pra, thatë ose  
14 vlerësuat që të paktën një pjesë e incizimeve në audio është e  
15 pashqeshme ose është ose është e padëshifrueshme. Pra, a mund  
16 të na thoni me sa siguri na thoni ju këtë përfundim që një  
17 pjesë e incizimeve në audio janë të padëshifrueshme?

18 PË. Jam shumë e sigurt.

19 PY. Pra, çfarë cilësie do kishin incizimet audio krahasimisht  
20 me dëgjimin në distancë dhe dëgjimin në mjedisin ku është bërë  
21 përgjimi? cila është cilësia fizike e një audio të tillë?

22 PË. Përgjithësisht kjo është shumë e ulët.

23 PY. Sa i takon testit, e kam fjalën këtu për dy burimet e  
24 pavarura të përkthimit, të z. Hysni Reçica dhe kompanisë  
25 tjetër, a mund të na thoni çfarë ju tregon ky eksperiment

1 lidhur me cilësinë e incizimeve në audio dhe transkripteve të  
2 ndryshme?

3 PË. Kjo i shton më tepër rëndësi konstatimeve të mia që  
4 cilësia e incizimit në audio ishte e padëshifrueshme në një  
5 masë të konsiderueshme, dhe gjithashtu thekson edhe rëndësinë  
6 e burimit ose informacionit kontekstual të jashtëm për të  
7 ndihmuar për zbardhjen. Pra, duhet të jem e sigurt që  
8 informacioni kontekstual i jashtëm të jetë i besueshëm dhe që  
9 analistët të jenë të pavarur, sepse e dimë se çdo  
10 karakteristikë orientuese e informacionit kontekstual me gjasa  
11 mund të ketë ndikim mbi transkriptin në mënyrë të tillë që  
12 është shumë e vështirë që të korrigjohen gabimet më tej.

13 PY. Në qoftë se ZPS-ja dëshironte që t'i provonte Gjykatës që  
14 incizimi audio ishte jo i dëshifrueshëm si do ta bënte ajo një  
15 gjë të tillë ose si demonstronte këtë gjë?

16 PË. Përmes disa kampionëve mbase me një përqindje të caktuar  
17 kampionësh të transkriptuar nga ekspertë të pavarur të kësaj  
18 fushe. Domethënë të incizimit në audio që janë të  
19 padëshifrueshme.

20 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.  
21 Faleminderit për përgjigjet.

22 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Profesore Fraser, kam unë  
23 disa pyetje për ju.

24 Pyetje nga Gjykatësi i Vetëm:

25 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në faqen 8 të raportit ju

1 thoni që incizimet në audio që janë pjesë e kategorisë së  
2 paqartë, dhe këtu citoj, "kërkojnë dëgjim shumë të kujdesshëm,  
3 por mund të kuptohen ... bazuar në kontekstin e brendshëm  
4 vetëm".

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në faqen 7 ju e përcaktoni  
7 kështu kontekstin e brendshëm, domethënë "fjalë të tjera në  
8 incizim".

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Pyetja e përgjithshme është  
11 kjo: A ka rregullore apo a ka udhëzime sipas mendimit tuaj që  
12 shtjellojnë se çfarë fjalësh të tjera në një incizim mund të  
13 përdoren në një kontekst të brendshëm?

14 PË. Pra, ndërkohë që i dëgjon fjalët, fjalët ndërtojnë një  
15 kontekst të caktuar, domethënë fjalët në vetvete ndërkohë që  
16 ti i dëgjojnë të krijojnë një lloj konteksti. Nuk e di në  
17 qoftë se ke ndonjë gjë konkrete në mendje me të cilën dëshiron  
18 që të të ndihmoj.

19 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Domethënë, sa më i gjatë të  
20 jetë një videoincizim forensik, i takon që më shumë kontekst  
21 do keni, domethënë, incizimin në audio sa më i gjatë të jetë  
22 aq më shumë fjalë ti mbledh, në mënyrë të tillë që të krijosh  
23 kontekstin për të prodhuar më pas transkriptin e duhur të  
24 fjalëve të paqarta ose të audios së paqartë?

25 PË. Është e vërtetë që kampionët më të gjatë ose kohëzgjatja

1 më e gjatë e incizimit në audio të japë më shumë kontekst.  
2 Por, gjëja kryesore këtu është që transkriptimi duhet të bëhet  
3 nga dikush që është ekspert i pavarur dhe a ka ekspertizë në  
4 këtë fushë kaq të ngushtë që është incizimi në audio të  
5 padëshifruar. Domethënë, sa më shumë i ekspozuar të jesh aq më  
6 shumë të rritet besimi dhe aq më të thjeshtë e ke për të  
7 identifikuar fjalët e caktuara. Por, nga ana tjetër negativja  
8 është, që në qoftë se ke bërë gabime për fjalë të caktuara,  
9 këto fjalët edhe të caktuara pastaj marrin tjetër rëndësi në  
10 qoftë se volumi i fjalëve është më i madh.

11 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ajo që sapo thatë a është  
12 njësoj e vërtetë sa i takon incizimeve në audio që janë të  
13 padëshifruara?

14 PË. Po. Domethënë ndërkohë që ti fillon që të dëgjosh fjalë,  
15 këto të ndihmojnë që të dëgjosh fjalë të tjera. E megjithatë  
16 është thikë me dy presa. Pra, mund të të ndihmojnë në qoftë se  
17 e identifikon siç duhet, por në qoftë se e identifikon gabim  
18 që në fillim, gabimi bëhet më i madh me kalimin e kohës. Pra,  
19 këtë e shikojmë shpesh herë. Në qoftë se njerëzit kanë një ide  
20 të gabuar lidhur me atë çfarë mendojnë ata që kanë dëgjuar,  
21 ndërkohë që teksti nuk ka qenë ai, atëherë gabimi zmadhohet me  
22 kalimin e kohës. Pra, kohëzgjatja në vetvete nuk është  
23 indikator thelbësor për sa i takon saktësisë.

24 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Nuk është thelbësore ose  
25 nuk është e vetmja, por gjithsesi rrit gjasat ose rrit

1 probabilitetin sa i takon saktësisë, apo jo?

2 PË. Po, mund ta thuash kështu, por kini parasysh një gjë që  
3 në qoftë se fillon me gabime ose në qoftë se dëgjon fjalë të  
4 caktuara gabim, atëherë rritet probabiliteti i gabimeve në të  
5 ardhmen

6 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, Profesore  
7 Fraser.

8 Nuk e di në qoftë se ka pyetje të tjera. Në rregull.

9 Përderisa nuk ka pyetje të tjera, dëshiroj t'ju  
10 falënderoj, Profesore Fraser. Faleminderit për dëshminë që e  
11 dhënë përpara Trupit Gjykues. Faleminderit për ndihmën tuaj.

12 Dhe Sekretarja tani do t'ju nxjerrë nga salla e gjyqit.

13 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

14 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Kemi një vendim për një  
15 parashtim shtesë lidhur me këtë dëshmitare, dhe ky ishte  
16 vendimi i ndërmjetëm për mocionin e Mbrojtjes së Thaçit për  
17 pranimin e dëshmisë së kësaj dëshmitare.

18 Në parim dua t'i drejtohem Prokurorisë, sepse Prokuroria  
19 është pala e parë që do t'i dorëzojë këto parashtime. E di që  
20 kjo është përcaktuar në vendim, mbase edhe në urdhrin pasues  
21 për sa i takon afatit të kohës për dorëzimin e këtyre  
22 parashtimeve. Por, duke marrë parasysh që ju nuk është se e  
23 keni kundërshtuar ekspertizën e dëshmitares në vetvete, dua  
24 t'ju pyes në qoftë se doni të vazhdoni me këto parashtime,  
25 çfarë do të përmbajnë këto parashtime apo doni që këto

1    parashtrime t'i përfshini lidhur me themelësinë e dëshmisë së  
2    dëshmitares. Pra, domethënë, me fjalë të tjera doni të bëni  
3    një parashtrim më vete apo doni ta bëni në dosjen  
4    përfundimtare.

5           Z. HAFETZ: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, më duhet të  
6    lexoj gjithë transkriptin, megjithatë unë mendoj që ne duam që  
7    të bëjmë -- të kemi një parashtrim tonin lidhur me qëndrimin  
8    lidhur me dëshmitaren. Megjithatë, domethënë, dorëzimin e  
9    parashtrimit do e bëjmë përpara afatit. Nuk kërkojmë kohë  
10   plus.

11          GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull. Sigurisht,  
12   domethënë, mund ta thoni dhe më vonë qëndrimin tuaj që se keni  
13   më shumë informacion. Megjithatë, për momentin faleminderit që  
14   më informuat që do bëni parashtrimin sipas afatit të kohës të  
15   përcaktuar.

16          Jemi pajtuar që dy palët do të shkëmbejnë dokumentacion  
17   ose listën e dokumenteve për numër provizor provash, dhe më  
18   pas mbështetur në informacionin që do jepni njëri-tjetrit ne  
19   do përcaktojmë numrat provizorë të materialeve përkatëse.

20          Vërej që Mbrojtja e Thaçit ka kërkuar pranimin e  
21   materialeve nga 5 deri në 15 të materialit përmes provave  
22   jogojore. Dhe ju, Prokuror, nuk është se e kundërshtuat  
23   kërkesën, në të kundërt e mbështetët kërkesën e Mbrojtjes së  
24   Thaçit. Kjo është dhënë në transkriptin e ditës së djeshme,  
25   besoj në faqen 59, në mos gabohem.

1           Besoj se mund të vendosim për pranimin e këtyre  
2   materialeve. Domethënë, nga 5 deri në 15 në listën për numrin  
3   provizor të provave të Mbrojtjes së z. Thaçi. Mirë atëherë, do  
4   vazhdojmë sipas këtij rendi.

5           Ky është urdhër gojor.

6           Materialet 5 deri në 15 të listës së materialeve për  
7   numra provizor provash materiale të Mbrojtjes së Thaçit i  
8   përmbushin kriteret për praninë sipas rregullës 138, dhe duke  
9   pasur parasysh që nuk ka kundërshtim Prokuroria lidhur me  
10   pranimin e këtyre materialeve, këto materiale pranohen në  
11   prova gjyqësore.

12          Ky është fundi i urdhrit gojor.

13          Dhe Sekretaria do bëjë një qarkullim të listës së  
14   materialeve përkatëse në një moment tjetër.

15          Ju kujtoj palëve për afatet e përcaktuar në paragrafët 21  
16   deri 23 të Urdhrit për Zhvillim të Mëtejshëm të Procesit  
17   Gjyqësor, që është parashtrimi F890. Këto janë dokumentet të  
18   cilat do duhet të dorëzohen menjëherë, dhe për këtë arsye po  
19   ja u sjell dhe një herë në vëmendje këto afate.

20          Po ashtu dëshiroj të theksoj që tre ditët e tjera të  
21   Gjykatës që ishin përcaktuar, domethënë, tre ditë të tjera për  
22   këtë proces gjyqësor, tani do hiqen nga kalendari.

23          A ka elemente të tjerë që doni të shtoni?

24          Z. Edwards.

25          Z. EDWARDS: [Përkthim] Dua t'ju them që kemi një paketë



1 të fundit të fakteve për të cilat palët janë pajtuar që do të  
2 qarkullohen gjatë ditëve në vijim. Besoj që gjatë javës do  
3 bëhet ky qarkullim i dokumenteve. Shikoj z. Hafetz që tund  
4 kokën. Pra, ne kemi diskutuar shumë edhe brenda përbrenda  
5 ekipeve të Mbrojtjes, por gjithashtu edhe të gjitha ekipet e  
6 Mbrojtjes me Prokurorinë. Nuk po kërkoj ndonjë përgjigje nga  
7 Gjykata për momentin, po thjesht doja të vija në dijeni lidhur  
8 me këtë.

9 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Do parashtroji deri të  
10 enjten? Do bëni dorëzimin deri të enjten?

11 Z. HAFETZ: [Përkthim] Po, besoj se po

12 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Keni ndonjë aspekt tjetër?

13 Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo. Mirë atëhere, e mbylлим këtu.  
14 Ju falenderoj.

15 --- Seanca mbyllet në orën 3.29

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25